

Albert RAMAJ

Burime dhe dëshmi

Stublla në dokumente arkivore austriake,
shkolla, kriptokrishtenizmi në Karadak

*Il sottoscritto attesta colla sua firma e col sigillo dell'uf.
fisco parrochiale di aver fatto la distribuzione dell'importo di
censati alle famiglie sopraccennate, in parti uguali d'un ducato
per famiglia*

Stublla li 16 Marzo 1808



M. M. Gualuluz

albanisches
institut

Albert RAMAJ

BURIME DHE DËSHMI

**Stublla në dokumente arkivore austriake,
shkolla, kriptokrishtenizmi në Karadak**

STUBLLA im Kosovo.

**Die Geschichte, die Schule und
das Krypto-Christentum der Karadakregion**

Herausgeber/Boton:

albanisches
Institut

www.albanisches-institut.ch

info@albanisches-institut.ch

Albanisches Institut

Postfach 7

9001 St. Gallen

Përgjegjës i botimit:

Abert Ramaj & Zef Ahmeti

Ballina:

Pjesë nga letra e dom Mikel Tarabulluzit

Katalogimi në publikim – (CIP)

Schweizerische Landesbibliothek

Albert RAMAJ. Burime dhe dëshmi. Stublla në dokumente arkivore austriake, shkolla, kriptokrishtenizmi në Karadak.

Stublla im Kosovo. Die Geschichte, die Schule und das Kryptochristentum der Karadakregion.

“Albanisches Institut“ – St. Gallen – Schweiz (Zvicër) 2008

295 P. Format: 15X21

ISBN: 978-3-9523077-4-8

Albert Ramaj

Burime dhe dëshmi

**Stublla në dokumente arkivore austriake,
shkolla, kriptokrishtenizmi në Karadak**

**STUBLLA im Kosovo.
Die Geschichte, die Schule und
das Krypto-Christentum der Karadakregion**

albanisches
Institut

St. Gallen 2008

**Ja kushtoj familjes:
prindërve,
vëllezërve,
motrave,
gruas.**

Përmbajtja, fq. 5

PARATHËNIE nga Zef Ahmeti, fq. 7

Hyrje. Fq. 11

I. INFORMACIONE DHE DOKUMENTE NGA ARKIVI SHTETËROR I AUSTRISË (VJENË) DHE STUBLLA ME RRËTHINË, fq. 27.

1. Tomë Raspasani, fq. 29.
2. Mbi martirët e Karadakut 1846-48, fq. 35.
3. P. Franë Koliqi, fq. 43.
4. Dom Zef Ramaj në Innsbruck të Austrisë, 45.
5. Shkolla e Stubllës, Mësuesi i saj Dom Mikel Tarabulluzi sipas dokumenteve arkivore, fq. 51.

II. “RARA” – LIBRA/MANUSPRIPTE E SHKRIME TË RRALLA, fq. 97.

Libra/manuscripte e shkrime të rralla mbi Stubllën, fq. 99.

1. Nos martyrs, fq. 99.
2. Arkivi i llazaristëve në Paris (Archives Lazaristes Paris, 95, rue de se-vres 75006 Paris) mbi Stubllën, priftin laraman Viktor Pashkun, fq. 100.
3. Jean-Claude Faveyrial libri “Histoire de l’Albanie” dhe Stublla, fq. 104.
4. Die Schulaktion in Albanien, fq. 105.
5. Jezuiti fratel Zefi nga Stublla, fq. 108.

IL Frate Zef e la missione volante (Giuseppe Valentini), fq. 112.

6. “Ditari” i don Mikel Tarabulluzit, fq. 117.

III. KRIPTOKRISHTENIZMI APO LARAMANIZMI NË KARADAK, FQ. 131.

Kriptokrishtenizmi apo laramanizmi në Karadak, fq. 133.

1. Inter omnigenas calamitates, fq. 134.
2. Quod provinciale, fq. 144.
3. Imzot Lazër Mjeda dhe laramanët e Karadakut, fq. 147.
4. Të pagëzuarit që mbahen fshehtë në Karadak, fq. 148.
5. Libër pagëzimi i kriptokrishterëve (matricularum baptizatorum cryptoca-tholicorum) në Stubëll, fq. 157.
6. P. Viktor Pashku (apo Shahin Ferizi) nga Selishta e Gjilanit - është prifti katolik shqiptar nga fshati “musliman”, fq. 159.
7. Hoxha i Lubishës ishte katolik, 161.
8. në Pozheran festoheshin Kërshëndellat e Pashkët, fq. 162.

9. Motrat Vincenciane në Stubëll e Letnicë dhe laramanët, fq. 163.

IV. BIBLIOGRAFI INTERESANTE, fq. 167.

1. Hylli i Dritës, 167.

2. Johann Georg von Hahn mbi Stubllën dhe kriptokrishtenizmin, fq. 167.

3. Misionet flutarake (missione volante) të Jezuitëve (italianë) në Kosovë dhe në Stubëll 1888-1912. fq. 175.

4. Albanija i Macedonija - Jakov Sliskovic, fq. 177.

5. Autorë të ndryshëm për martirët dhe atë Anton Maroeviqin, 178.

6. Në nder të Zojës Cernagore /n`Cërnagore kem një Nanë, fq. 180.

7. Kanga e popullit (Në ndeer të Zojës Cernagre), fq. 182.

8. Atë Gjergj Fishta për Stubllën, fq. 190.

9. Die Geschichte der Krypto-katholiken (Laramanen) – Franjo Djuric, fq. 194.

10. Vajtimit nga Stublla, fq. 195.

11. Zef del Gaudio: Martirët shqiptarë (1846-1848)., fq. 195.

12. Don Dedë Ramaj dhe një letër më 1966, fq. 196.

V. BURGOSJA DHE LARGIMI I DOM MIKEL TARABULLUZIT, fq. 203.

1. Burgosja e Don Mikel Tarabulluzit dhe Imzot Lazër Mjedës, fq. 205.

2. Largimi i Don Mikelit nga Stublla dhe letra e tij më 1912, fq. 216.

VI. Uraniumi i tepërt në Stubëll?, fq. 223.

Uraniumi i tepërt në Stubëll?, fq. 225.

1. Field experience of indoor thoron gas measurements in a stable rural community in Yugoslavia, fq. 225.

VII. LOJTARËT E KOMBËTARËS ITALIANE DI FRANCESCO DHE TOMMASI VIZITONJË STUBLLËN, fq. 233. .

1. Dy lojtarë itailanë vizitajnë stubllën – Eusebio di Francesco & Damiano Tommasi, fq. 235.

2 Damiano ed Eusebio a Stublla, fq. 236.

VIII. BIBLIOGRAFI MBI STUBLLËN, fq. 239.

bibliografi mbi stubllën, fq. 241.

IX. KRYPTO-CHRISTENTUM IM KOSOVO (STUBLLA), fq. 259.

Lebensäußerungen der „Doppelgläubigen“ . fq. 263.

Laramanen in heutiger Zeit, fq. 264.

PËRFUNDIM, 267.

X. FOTOALBUMI , fq. 269.

“MARUBI” I STUBLLËS – SHIN SHABANI, fq. 269.

“Marubi” i Stubllës – Nga Fototeka e Shin Shabanit, fq. 271

PARATHËNIE

Kur marrim në gojë fjalën “histori” neve aty për aty na shkon mendja se bëhet fjalë për diçka që ka ndodhur në të kaluarën. Semantika e kësaj fjale (nën)kupton tërësinë e fakteve, ngjarjeve dhe dukurive të rëndësishme që janë të lidhura ndërmjet veti; karakterizojnë proceset, jetën e zhvilluar, apo edhe tërësinë e të dhënave dhe të ngjarjeve me rëndësi që lidhen me dikë a me diçka dhe që e karakterizojnë atë nga ana e jetës dhe e zhvillimit. Nga ajo që u tha, na del rëndësia e veçantë e “tërësisë së fakteve” në gjurmimet historike, në kërkimet e burimeve dhe të dëshmimeve për një individ, ngjarje, vend a popull. Pos kësaj, flitet edhe për faktin se historia merr si lëndë studimi “ngjarjet me rëndësi”.

Një studim që ka për qëllim të zbardhë një ngjarje, apo ndodhi të ndryshme për të fituar një bindje, duhet të ketë burime të ndryshme, të drejtpërdrejta apo të tërthorta që flasin për lëndën që pretendohet të studiohet, të zbardhet.

Nisur nga ky këndvështrim, lexuesi në këtë punim, mbase kryekëput historik, ka mundësi të pasurohet me informacione që japin një pasqyrë në shumë drejtime. Nxjerrja në dritë e burimeve dhe fakteve që flasin për vete, mbase shpesh është punë e lodhshme, sidomos kur një punë kërkimore për zbardhjen e disa aspekteve historike – qoftë të një individi, qoftë ngjarja si e tillë apo edhe të segmenteve tjera sociale, politike – bëhet krejtësisht në bazë të vullnetit të mirë pa ndonjë shpërblim material për kohën dhe mundin, e aq më pak për atë intelektual. Dhe kjo ndodh kështu, kur një vend ka sfida tjera sociale me prioritet të theksuar, por edhe për shkak të egocentrizmit, ky fenomen për shumë shoqëri ka shkaktuar pasoja të rënda.

Dihet se publikimet e Dr. Dom Gjergj Gjergjit sidomos mbi martirët e Karadakut (1846-1849) janë për t’u çmuar shumë. Kurse ky punim i Albert Ramajt plotëson atë që deri më tani na mungonte dhe me shumë dokumente të bashkangjitura. Në punët kërkimore është e një rëndësie të madhe cekja e fakteve dhe burimeve mbi të cilat autori bazohet dhe mbështet mendimet, mëtimet, tezën a teorinë. Në studimet shqiptare vërehet shpesh se janë bërë plagjiatura,

duke menduar, mbase, me bindjen e thellë, se nuk do të ketë tjetër që do të merren a studiojnë më tutje. Ky fenomen vërehet edhe tek disa “kolosë”, të cilët i janë imponuar masës me punimet e tyre, duke besuar se e thonë “të vërtetën”. Fenomeni i shtrembërimit të fakteve historike është i pafalshëm, kur ai bëhet me vetëdije të plotë. Një studiues i mirëfilltë bazohet në faktet dhe burimet, të cilat edhe mund t'i dëshmojë, e para së gjithash, tek një i tillë shihet menjëherë mëtimi objektiv për ta zbardhur një aspekt historik.

Në disa studime të deritanishme që janë bërë mbi Stubllën, vërehen elemente të lartcekura, qofshin ata vendorë apo edhe tek studiuesit e tjerë. Ky punim që keni në duart tuaja, zbardh shumë gjëra dhe si i tillë, për disa do të jetë edhe pasqyrë e punës së mirëfilltë.

Vërtetë, mbi Stubllën me ngjarjet dhe personalitetet, së bashku me pozitën e saj gjeografike dhe rrethinën, të dhënat historike janë a-shtu të shumta, sa është e pabesueshme. Ky vend i vogël ka një histori të gjallë, të prekshme. Proceset, situatat, njerëzit, ngjarjet e nxitura e të prodhuara nga ky vend kodrinor, kanë pasur peshë vërtetë të fuqishme për kohën kur kanë ndodhë. Reflektimi ka qenë sa rajonal e besa edhe më gjërë mbase edhe ndërkombëtar, sidomos viti 1846-48. Ky vend ia del drejtpërdrejt apo tërthorazi të vërë në lëvizje edhe diplomacinë aktuale të shteteve fuqi të kohës.

Ky libër plotëson e nxjerr fakte të reja për disa segmente që deri më tani kanë qenë jo mjaft të qarta e argumentuese. Publikohen risi. Ngërthen në vete një pasqyrë më të kompletuar deri më tani. I ofron lexuesit informacione të ngjeshura, sa mund të nxisin që të bëhen studime të veçanta për fusha të caktuara. Dhe poashtu bibliografia që është bërë nga ai, është punë që do të shërben jo vetëm lexuesëve të thjeshtë, por studijuesëve dhe shifet shumë qatë, se për një vend kaq “të vogël” sa mund të ketë shkruar jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe ato evropiane. Bibliografia mbi Stubllën, jo edhe ndoshta complete siç pohon edhe autori i këtij libri, botohet për të parën herë. Nuk ishte punë edhe aq e lehtë të përpilohet kjo monografi.

Poashtu edhe fotoalbumi e sidomos ai i Shin Shabanit është pasuri në vete dhe fotografitë mund të flasin vet.

Kam pasur mundësinë ta përcjell Albert Ramaj gjatë punës së tij. Më informonte përherë rreth ecurisë së punës. Çdo njoftim që ma bënte për burime të reja, të siguruar, më fascinonte. Ishin vërtetë dëshmi që të nxisnin kureshtjen. Ishte i interesuar ta studionte çdo burim, çdo fusnotë të cituar. E kërkonte burimin, aty nga vinin faktet. Nuk e kënaqnin citatet e theksuara. Metoda e punës së Albertit vërtet është për shembull. Përvoja, njohja e burimeve dhe metoda e punës së tij, më së miri pasqyrohet me këtë libër. Ky ka një respekt të veçantë kundruall gjithë studiuesve të tjerë e që shprehet me bibliografinë e pasur e më të plotën deri më tani. I vetëdijshëm se historia është një “det” i gjerë, ai nuk mëton se janë thënë të gjitha. Ka edhe më shumë.

Zef Ahmeti

Hyrje

Shikuar në aspektin gjeografik dhe nga sipërfaqja e saj, Stublla është një vend shumë i vogël, duke pasur parasysh të gjitha ato shkrime dhe publikime që janë bërë e bëhen mbi këtë vend, ai vend del se është shumë i madh. Stublla (komuna e Vitisë) gjendet në juglindje të Kosovës. Në aspektin historik, kulturor e religjioz, ky vend luante (dhe luan) rol të madh në shumë periudha historike, tërthorazi ose drejtpërdrejt. Me ngjarjet dhe personalitetet e veta, u bë fole kulture jo vetëm për rrethin, por edhe më gjerë. Shumë studiues vendas, sidomos Dr. don Gjergj Gjergji-Gashin,¹ studiues tjerë shqiptarë, por edhe të tjerë ndërkombëtarë, nxiten që të shkruajnë për këtë vend, mbase, si i tillë, assesi nuk mund ta kapërcejnë pa folur e shkruar për të.


Kur shkruhet mbi Stubllën është e nevojshme, patjetër, të merret në trajtesë edhe Letnica, duke pasur parasysh faktin, se fshati Stubëll ishte bashkërisht me famullinë e Letnicës deri më 1905.

Letnica: në radhë të parë, mendohet se ky vend sikur krijohet pëshlypja se kemi të të bëjmë vetëm me komunitetin kroat (për fat të keq tashmë i shpërngulur në Kroaci pas vitit 1990). Famullisë së Letnicës, Montenegro di Scopia, e njohur edhe si Skopska Crnagora apo Karadak, i përkisnin disa fshatra si: Letnica, Shashari, Vernezi, Vernakolla, Stublla, Binça, Selista, Terzijaj, Dunav e shumë vendbanime të vegjël të rrethinës. Kjo famulli është e njohur si shenjtërore e ipeshkvisë, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Edhe në Shqipëri njëhej që më parë ky rajon, siç vërehet nga publikimet e dom Mikel Tarabulluzit që i kishte shkruar në Elçija e Zembrës së Krishtit qysh në shekullin e 19 dhe që disa ia kemi bashkangjitur këtu.

Supozohet se kroatët që kanë jetuar deri vonë në Letnicë, Shasharë, Vernezë kishin ardhur nga Raguzia (Dubrovniku), para ardhjes së turqve në Ballkan. Ardhja e „raguzianëve“ në këtë rajon dhe në Ballkan, ishte bërë për shkaqe ekonomike; pra, për arsye se ata konsideroheshin e merreshin për mjeshtër të minierave dhe puna që bënin, lidhej me minierat. Mbi Letnicë dhe në Krato-

vë-Zletovë2 gjendeshin më parë miniera të njohura jo vetëm për territorin e Ballkanit, por edhe më gjerë. Siç na e bëjnë të ditur edhe don Gaspër Gjini e imzot Alojz Turk e shumë autorë tjerë, po ashtu edhe miniera të tjera ishin të njohura si në Trepçë (Stari Trg), Novobrdë, Janjevë e nëpër shumë vende të Ballkanit që lidheshin me raguzianët dhe sasët nga Gjermania e sotme.

Shkrimi i don Mikelit publikua në: Elçia e Zembrës Krishtit (5 shtator 1895)



Vlen të thuhet se për këto miniera ishin më të përshtatshmit specialistët sasë (Sachsen) nga Gjermania e sotme, që vinin të punonin sidomos si udhëheqës apo specialistë të minierave. Por duhet theksuar se edhe popullata vendore ishte punësuar në këto troje, së paku si fuqi punëtore e thjeshtë. Nga kjo mund të konstatohet se edhe emrat kishin mbetur nga sasët, sikur Shashare përmbi Letnicë, Shashkovci afër Janjevës, në Maqedoni Sasi. Raguzanët dhe Sasët që kishin ardhur për të punuar në këto miniera si specialistë në këto treva, ishin vetëm meshkuj, të cilët kishin sjellur me vete edhe priftin e tyre për shërbime fetare. Po ashtu, është për t'u theksuar se këta meshkuj ishin të rinj dhe nuk mund të udhëtonin aq shpesh në atë kohë në vendlindje dhe disa prej tyre duhet të ishin martuar në këto troje me vajza vendase, duke krijuar familjet e tyre: të njëjtën gjë duhet ta kishin bërë edhe disa raguzianë. Me ardhjen e turqve në Ballakan, gjendja shoqërore e tyre dhe e vendasve u ndryshua rrënjësisht, por jo që në fillim, sepse në fillim turqit i toleronin xehëtarët kurse më vonë jo. Dhe kështu gradualisht u shkatrruan edhe minierat e këtushme që ekzistonin, sikur ajo përmbi Letnicë, në Kratovë e më vonë edhe në Novobërdë e Janjevë. Ndërsa specialistët sasë dhe punëtorët raguzianë që tashmë në këtë vend e kishin filluar jetën e tyre familjare dhe kishtare, nuk mund të ktheheshin edhe aq lehtë në vendlinje, por mbetën në këto rajone dhe e nisën ekzistencën e tyre familjare me veprimtari të tjera, si me blegtori apo me gjëra tjera të ngjashme, për shkak se vetë natyra e atyshme e krijonte mundësinë për këtë gjë. Jeta kishtare e këtyre njerëzve u përshtat me atë të popullatës vendase, e cila edhe më parë jetonte aty. Të theksojmë se fjala është për Letnicën, Shasharin e Vernezin; ndërsa për pjesën tjetër të kësaj famullie, sikundër janë fshatrat Stubëll, Binçë, Kabash, Terzijaj, Dunav e më gjerë, apo edhe në Kratovë, kemi të bëjmë me diçka tjetër, sepse këto vende janë me popullsi, e cila edhe më parë jetonte në këto vendbanime. Duhet të bëhen kërkime të mëtutjeshme për jetën e popullatës krishtere jo vetëm në Stubëll, por edhe në rrethinë; por, këtu dëshirojmë të nënvizojmë se është e mundur që ekzistenca e këtushme e kësaj popullate të jetë bërë e njohur qysh në Mesjetën e vonshme, jo vetëm në këtë rajon, por

edhe më gjerë, sikurse është miniera sipër Letnicës e, po ashtu, sikurse janë edhe sasët apo raguzanët. Stublla përmendet për të parën herë (deri më tani, sa dimë) qysh më 1455 në një teftër turk dhe ku shënohet emri *Stubëll*. Thuhet se Stublla kishte 47 shtëpi, tri të veja dhe 13 të pamartuara. Kurse më 1477 shënohet në një hartë topografike të Shkupit, kur përmendet Caravajka, kurse si pikë orientimi përmendet Stublla. Më 1584, vizitatorët Tomaso Raggi dhe Aleksandër Komulloviq, mendojnë dhe i shkruajnë Vatikanit për hapjen e një kolegji, kurse shënimi i tyre për rajonin si „Montenegro di Scopia“, në mos është fjala për Stubllën, është i diskutueshëm; një gjë dihet, se fakte nuk ka, por dihet se kjo gjë ishte vetëm dëshirë e këtyre dy vizitatorëve, kurse kjo punë më nuk u përmend kurrë nga këta persona apo nga persona të tjerë kishtarë, kuptohet sipas atyre dokumentëve që deri më tani kemi hulumtuar. Deri më tani nuk kemi hasur në ndonjë dokument, por, siç duket, kjo dëshirë për hapjen e një kolegji të atëhershëm në këtë rajon, u realizua në Janjevë e jo në „Montenegro di Scopia“; apo ndoshta është e pahulumtuar e dhëna e tillë. Arsyeja pse këta dy vizitatorë kishin shprehur mendimin që të hapin një „kolegj“ në këtë rajon, është e qartë: për shkak të pozitës gjeografike, sepse mund të fsheheshin nga turqit. Por këtu do theksuar edhe një gjë: në përjashtim të hapjes apo moshapjes së kolegjit kishtar. Pra, ky rajon, duke përfshirë këtu edhe Stubllën, duhej që atëherë të ngjallte interesim për vizitatorët nga Vatikani, sepse po shihet qartë se ata kishin bërë vizita këtu dhe e njihnin mirë. Do kërkuar raportet e tyre të ndryshme për këto gjëra; jo vetëm të bazohemi në atë që deri më tani është stërpërsëritur.

Por dihet se, sipas J. Rexhepagiq dhe më vonë, edhe sipas Dhimitër S. Shuteriqit, Stublla mund të ketë qenë vend i përshtatshëm për hapjen e një kolegji kishtar qysh në këtë kohë. Do cekur, se ndoshta janë të humbura ato dokumente që do të mund ta argumentonin këtë gjë, sepse kohërat e zymta në këto troje nuk mund të ishin të përshtatshme, kur ekzistenca njerëzore ishte në zgripç e nuk ishte edhe aq lehtë të ruheshin dokumente apo gjëra historike. Por edhe një fakt është shumë i rëndësishëm: më 1963 ndodhi tërmeti në Shkup, ku i tërë arkivi ipeshkvor u fundos në tokë, kështu që

hulumtuesit tanë janë tashmë të detyruar që të hulumtojnë nëpër arkiva të ndryshme evropiane për çdo gjë që ka të bëjë me historinë e ipeshkvisë dhe të famullive nëpër Kosovë. Dhe po ashtu më parë (më 1944) dihet se gjatë Luftës së Dytë Botërore, një bombë e goditi godinën ipeshkvore në Shkup, me ç'rast pjesa më e madhe e bibliotekës dhe e shkrimeve të ndryshme, u përfshi nga flakët. E pra, nuk është edhe aq lehtë „të grumbullohen“ dokumente për këto gjëra. Vetëm me një mund të madh mund të arrihen. E këtë po e themi nga përvoja.

Do hulumtuar edhe thënia e Dhimitër S. Shuteriqit, i cili shkruan për Stubllën kështu: “Qysh më 1584, në Letnicë të Shkupit, më pas edhe në Shtumbulla të Gjilanit, në dy fshatra shqiptare kanë funksionuar kolegje fetare. Kolegjet e kohës ishin shkolla të larta. Aty përveç teologjisë, mësohej filozofia dhe studijoheshin klasikët”³

Më 1846-48 ndodhi që okupatori turk i internoi banorët e fshatrave të Karadikut; si ata të Stubllës, Binçës, Terzijajt, Vërnakollës e disa të tjerave përreth, për në Turqi e të cilën ngjarje e ka hulumtuar Gjergj Gjergji-Gashi. Jeta e këtyre të internuarve ishte tejet e vështirë gjatë kësaj kohe, sa që shumica prej tyre u vranë apo vdiqën gjatë maltretimeve që iu ishin bërë. Një pjesë e vogël e tyre u kthye në vendlindje dhe filloi jetën normale. Këtyre të internuarve u kishin dalur në ndihmë fuqitë e mëdha, sikur Franca, Anglia, Austro-Hungaria e disa vende të tjera. Është me interes të përmendet se Franca u kishte ofruar strehim të gjithë atyre që kishin mbetur gjallë në një fshat dhe me kushte shumë të mira materiale për të vazhduar jetën e tyre. Por këta me dëshirën më të madhe u kthyen në vendlindje e vet, pra në fshatrat Stubëll, Binçë, Vërnakolla e Terziaj.

I do bërë një hulumtim më rrënjësor shkollës së Stubllës, ç'prej se ekziston, si dhe vazhdimësisë së saj nëpër kohë. Shpresojmë se së së shpejti do t'i hyjmë kësaj pune. Sipas Sarë Gjergjit⁴, shkolla e Stubllës duhet të ketë pasur kontinuitet e cili bazohet, përveç në shkrimet e autorëve të ndryshëm. edhe në përdorimin e një logjike apo konstatimi. Duket se diçka duhet të kish pasur, porse saktësisht mbetet të hulumtohet dhe kjo gjë është më se e ditur se shkolla

është zhvilluar në kaudër të Kishës. Por nuk do lënë anësh as Shkolla e Letnicës. Ndoshta është bërë një mësim në këtë famulli, paralelisht në gjuhën kroate për popullatën kroate në Letnicë e për gjuhën shqipe në Stubëll. Edhe Radoshin Rajoviqi thotë se: "...u hapën edhe dy shkolla në gjuhën shqipe: një në Stubëll (rrëzë Karadakut të Shkupit), u hap më 1846 dhe tjetra në Prizren që u hap më 1889".⁵ Është për tu befasuar se si ky autor përmend datën 1846, pra kur martirët e kësaj ane u internuan në Turqi. Pra, shtrohet pyetja tjetër, që deri më sot e kemi anashkaluar: a mos martirët e kësaj ane edhe për shkak të mësimi shqip ishin internuar, maltretuar; dhe kishin vdekur edhe për shkak të mësimi që kishin bërë në gjuhën shqipe, mbasi dihej se deri me dekretin e reformës së vitit 1856, Turqia nuk lejonte që të hapej ndonjë shkollë publike në Kosovë e as që lejonte që këto shkolla të financoheshin nga jashtë, si nga Austro-Hungaria. Nëse do të kishte ndonjë "lëvizje arsimore" në këtë vend, atëherë duhej që turqit t'u kishin rënë në gjurmë këtyre veprimtarive dhe popullata do të kishte probleme. Dihet se shkak kryesor i internimit të tyre ishte ai religjioz; ndoshta do të mund të ishte edhe një shkak më shumë, nëse i kishin zënë prifërinjtë duke i mësuar shkrim e lexim. Pse shtrohet kjo pyetje kështu? Për arsye se në famulinë e Cërnagorës në këtë kohë kishte edhe kroatë edhe shqiptarë; pra, asnjë familje kroate nuk u internua në Turqi. U internuan vetëm shqiptarët. Disa mendojnë se kroatët nuk ishin kriptokatolikë, por kriptokolikë ishin vetëm popullata shqiptare.

Disa supozojnë se qysh para vitit 1905 kishte shkollë shqipe në Stubëll, por gjërat janë të paargumentuara mirëfilli. Nuk dëshirojmë as ta themi poshtë as t'i stërmadhojmë gjërat, por dëshira jonë është që të argumentohet kjo gjë mirëfilli, mbasi deri më sot nuk kemi pasur argumente të besueshme për këtë çështje, përveç fjalëve apo hipotezave. Sipas mendimit tonë, një "shkollë" e tillë duhet të kish ekzistuar qysh në vitin 1888 dhe duhet ta ketë themeluar dom Bartolome (Bara) Fantelan; dhe kjo duhej të ketë qenë një „shkollë“ që kishte zgjatur aq sa qëndroi Don Bara Fantelan në famullinë e Cërnagorës, e cila, me largimin e tij, përfundon. Kjo mund të argumenton këtë që thamë më lartë, sepse

kjo ishte normale në fund të shekullit të 19. dhe në fillim të shekullit 20 që të ndodhte gati në çdo famulli katolike në territorin e Kosovës apo Maqedonisë. Don Nikollë Mazrreku (është i varrosur në Stubëll) bëri të njëjtën gjë më 1911 në Mitrovicë, ku nu nuk kishte shkollë në gjuhën shqipe, por ai tuboi të gjithë fëmijët krishterë rreth veti dhe në mbrëmje u jepte mësim e lexim. don Bartollome Fantela të njëjtën gjë e kishte bërë edhe kur ishte famullitar në Mitrovicë. Më 9 janar 1911 (faksimil i kësaj letrë është në këtë libër) shkruan konzulli austro-hungarez nga Mitrovica se në këtë rreth nuk ka shkolla katolike, kështu që edhe ipeshkvi i ipeshkviës së Shkupit do të gëzoj për këtë punë nese don Nikolla Mazarreku i tubon fëmijët krishterë rreth veti dhe i mëson shkrim e lexim në kishën e Mitrovicës dhe është e nevojshme që të pasurohet me libra në gjuhën shqipe. Pra, edhe pse nuk kishte shkollë zyrtare në gjuhën shqipe, prapseprap prifti i këtushëm tubonte rreth veti fëmijët që ti mësonte. E njëjta gjë duhej të ksihe ndodhur edhe në Stubëll së paku që prej 1888, sepse jo formë e organizimit të mësimi për fëmijët shiptarë nëpër famulli katolike në Kosovë ishte e rëndomt në atë kohë. Don Fantela kishte hapur edhe një shkollë kishtarë në gjuhën shqipe në Ferizaj.

Por është tepër me interes të përmendet se qysh më 23 qershor të 1895 (shih edhe faksimilin e atij shkrimi në këtë libër) vetë mësuesi Dom Mikel Tarabulluzi në një shkrim të botuar në Shkodër te Elçia e Zemrës së Krishtit, përmend një fëmijë në Cërماغore që ishte lënduar dhe që shkonte në shkollë.

Një punë të vjeshme dhe shumë me rëndësi, e rindërmori apo ndërmori Dom Mikel Tarabulluzi më 1905, kur me të vërtetë hapi një shkollë shumë të rëndësishme, jo vetëm për Stubllën, por edhe për tërë rajonin dhe Kosovën. Siç duket, dom Mikeli ishte i lidhur edhe emocionalisht me këtë vend, sepse e donte dhe punonte shumë e nuk frigohej aspak as nga pushtuesit turq e më vonë as nga ata serbë. E burgosnin, por prap vazhdonte punën e vet edhe pas atyre maltretimeve e qortimeve që ia bënin. E gjithë puna e tij që është bërë sidomos prej 1905 e deri më 1922, gjendet në disa dokumente dhe informacione biografike, prandaj këtë gjë më shumë po e lëmë për trajtim brenda tekstit, sesa këtu, e këtë mund

ta vërejtje edhe lexuesi. Teksti është i përcjellur me disa faksimile arkivore apo i vendosur edhe në fund të librit dhe po ashtu me një bibliografi të pasur dhe deri më tani më të kompletuarën mbi këtë temë.

Ti kthehemi prapë famullisë së Černagorës. Kishat që kanë ekzistuar në këto vende e rrethinë deri më tani e që dihen, ishte ajo të shën Gjergjit në Letnicë, kurse e Zojës në Kratovë e Shkup.

Kisha në Letnicë iu kushta Zojës, siç duket, pas disfatës së ushtrisë krishtere që e pësoi nga ajo turke në Shkup më 1671, kur turqit mandej shkatërronin çdo gjë që kishte të krishterë nëpër qytet të Shkupit. Kështu, të krishterët e Shkupit u larguan nga ky vend dhe nuk mundën për të shpëtonin asgjë nga katedralja e atëhershme Shkupit, por arritën të merrnin me vete vetëm truporen e Zojës së Bekuar, e cila edhe sot gjendet në Letnicë. Apo ndoshta e njëjta gjë ndodhi më vonë, kur u shkatërrua shenjtërorja e Zojës në Kratovë dhe kështu u transferua në Letnicë. Nuk dihet saktësisht se truporja e Zojës së Letnicës, e cila gjendet edhe tash aty, a është prej Shkupi apo prej Kratove. Dhe nëse është prej Shkupit, do të thotë se në të njëjtën kohë apo më vonë është transferuar shën Gjergji në Stubëll, pasi që një kishë nuk mund t'i ketë dy patronë. Rrëzë kodrës së Stubllavaqës deri vonë ishin edhe themelet e një kisha të vjetër, asaj të Shën Gjergjit. Dihet edhe sot se kisha e vjetër në Stubëll iu kushtua shën Gjergjit. Atëherë nëse është ashtu, kjo duhet të kish ndodhur menjëherë pas vitit 1671, kur besimtarët e transferuan në Letnicë Zojën e Bekuar nga Shkupi për ta fshehur nga turqit. Dihet shumë mirë që shën Gjergji ishte shenjt që kremtohej jo vetëm nga shqiptarët (edhe muslimanët) në zonën e Karadakut, por edhe nga i tërë populli shqiptar pa dallim feje. Kjo festë kremtohet edhe sot jo vetëm nëpër familjet katolike, por edhe në tërë familjet myslimane dhe llogaritet si festë popullore. Ndoshta kjo popullatë shqiptare dëshironte të ketë shenjtin e vet në një pjesë më të fshehur nga syri i pushtuesit, sikur është ai vend në Stubëll ku janë ende themelet. Me të vërtetë është shumë i fshehtë ai vend në Stubëll, i cili vështirë të gjendej nga turqit. Nëse Zoja e Letnicës është nga Kratova, atëherë duhet të hulumtohen gjërat se deri kur ishte Kratova famulli. Ndoshta pas shuarjes së famullisë, kjo trupore

është sjellur në Letnicë (Kratova është sot në Maqedoni). Nuk duhet lënë anësh faktin se Kratova e Cërnegora nuk janë larg njëra me tjetrën, edhe pse sot Kratova është vend që gjendet në Maqedoni, kurse Letnica në Kosovë. Që të dy vendet gjenden malin Montenegro di Scopia (Skopska Cernagora), kështu që mungesa e priftërinjve në kohën e turqve, ishte shpesh e madhe, kurse një prift mund të kujdesej ndoshta ndonjëherë edhe për Kratovën edhe për famullinë e Montenegro di Scopia, ashru si ndodhi më 1703 (sipas Peter Bartl)⁶. Famullia e Letnicës është quajtur përherë Montenegro di Scopia, edhe pse edhe Kratova bën pjesë në malin e Montenegros së Shkupit apo Skopska Crnagora. Mali i Zi i Shkupit nuk është përdorë gjatë shkrimeve që kemi hasur deri më tani. Ky term është futur shumë vonë në shkrime përmes autorëve shqiptarë.

Është një raport i Vincenzo Mattevich shkruar Kongregatës më 7 gusht 1670 mbi shkollën në Janjevë dhe ku bënë fjalë edhe për Karadakun. Një pjesë të tij po e sjellim këtu, që të shifen edhe disa nga ato që më lartë i cekëm: Mattebvich shkruan kështu:

Non hà il sud[ett]o luogo di Trepchia alcuna sorte di rendita, nè emolumento fitor di q[ue]llo, che li viene dalla Sac[ra] Cong[regatio]ne benignam[en]te somministrato all'anno. Onde con le med[esi]me provisioni godute dagl'Antecessori, necessarijssimo spedire Tomaso Raspasanovich.

Vi è parim[en]te la missione di Montenegro, dove vi sono sparsi molti villaggi, quali al p[resen]te non numerano più di trenta case Catoliche poverissime, essendo l'anno passato una mano fugite via p[er] l'aggravio del tributo. Sono qui due Chiese, la parrocchiale di S[an] Giorgio, e l'altra dell'Assunzione, ambedue asistite da [Padre] frà Bernardino minore osservante nativo del luogo, persona di zelo, e bontà. Viene questo con il solito sussidio mantenuto dalla Sac[ra] Cong[regatio]ne. Hà la Chiesa un molino, mà per esser absentati li popoli, li riesce quasi di niun emolum[en]to. V'hà di più un pezzo di vigna, con la quale pub forse sovenire se med[esi]mo di vino p[er] un mezzo anno incirca.

Vi è app[ress]o il hiogo di Cratovo numeroso di case trecento incirca; mà sole otto case Christiane, essendo diminuiti dalla peste. Hà

una devotiss[im]a Chiesa sotto l'invocat[i]o[n]e della Madonna S[antiss]ma, tiene una vigna, dalla quale il Sacerdote può estrarre vino p[er] tutto l'anno. Serviva qui D[on] Luca Ungaro, mà non potendosi mantenere, p[er] non venirli à tempo le provisioni, abbandonò la servitù, et andò à servire li Sig[nori] Mercanti Ragusei in Procopie p[er] Capellano con la provisione di settanta scudi l'anno, oltre il vitto da ogni spesa netto. Nel luogo di Cratovo non si trova al p[rese]nte sugetto; mà viene asistito de volta in volta dal Missionario di Montenegro, e dal paroco di Scopia, sodisfacendoli q[ue]lli poveri Christiani tutte le volle della loro fatiga, et incomodità, fino à tanto, che la benignità della Sac[ra] Cong[regatio]ne si compiacchia di provederlo di proprio sugetto con l'ordinaria provisione.⁷

Kurse Andrea Bogdani shkruan më 7 shkurt të 1673 kështu:

Adi 30 luglio fui in Montenegro, e doppo la funt[i]o[n]e ep[iscop]ale predicai e cresmai anime quaranta sette. Sotto questa miss[i]o[n]e vi sono otto Villette, delle quali sei sono vicine l'una all'altra.

In Letniza à la Chiesa parochiale di S[an] Giorgio Martire fatta di sassi e calcina, coperta di coppi, hà il cimiterio attorno, hà appresso di se la casa dove risiede il Paroco. Giorni festivi e giorni di domeniche qui concorre il Popolo alla messa, non essendo maggior distanza d'un hora da altre cinque Ville, alla Chiesa di Letniza danno il segno p[er] la messa à sud[ett]e Ville, battendo in una tavola in luogo della Campana, che sentono beniss[im]o tutti. Hà un molino, dal quale il Paroco può cavare sufficiente pane p[er] tutto l'anno p[er] se e per Chierico. Haveano comprato un pezzo di vigna, pagando la metà di denari p[er] quanto erano stati d'accordo nel prezzo; e p[er]ché al tempo prefisso non hebbero quelli poveri con che pagar il resto, fù ripigliata di nuovo da chi l'havea venduto. Hà alcuni prati, da quali il Paroco

può sufficient[emen]te proveder il fieno al suo cavallo, il quale li é necessarissimo p[er] visitare le due Ville di Gadise e Slavchovze, quali sono lontane da Montenegro sei hore, mezzo di q[ue]sto viaggio, che il Mission[ari]o fà in visitare queste due Ville, è pianura, et altro mezzo è muntuoso, aspro e pericoloso.

Appresso la Chiesa di S[an] Giorgio vi è in Sciasciare una di sopra d[ett]e Ville un'altra Chiesa di Madonna S[antissi]ma, fatta di sassi e calcina, coperta di coppi. In tutte due Chiese vi sono cinque pianete, due sono bene in essere, tre quasi straccie, hà due croci, due calici con due patene, uno tutto d'argento, dell'altro sola cuppa, hà un turibulo di argento di valuta di quaranta reali, hà ancora due crocette pure d'argento con legno dentro. In tutte sud[ett]e Ville sono sessanta case, anime quatrocento inc[irc]a, piccoli e grandi, essendo stati sforzati dal Turco q[ue]lli, che si erano slontanati dalle proprie case p[er] gl'aggravij de' tributi, che di nuovo tornassero alle proprie Ville. Serve al p[rese]nte in questa miss[i]one D[on] Natale Bacich, è in età di 33 anni, attende puntualm[en]te al suo ufficio, hà studiato nel suo Paese.⁸

Është me interes për t'u përmednur edhe Kisha në Dunav që i kushtohet Anës dhe Joakimit (është e njohur në popull Kisha e shën Prenës), pra prindërve të Zojës Mëri. Kishë në Dunav iu kushtua, pra, Shën Prenës dhe dihet se në Kratovë ishte një Kishë e Zojës. A mos ndoshta ishte ky shkaku që në Dunav iu kushtua Shën Prenës, pasi që në afërsi të Dunavit, pra në Kratovë më parë kishte një kishë të Zonjës e mos të humbet kjo draditë e mëparshme. Për fat të keq, dihet se në vitin 2000 kisha në Dunav është sulmuar nga disa persona, kurse truporja e shën Anës u gjet më vonë në mal. Më vonë është marrë ajo trupore dhe është vendosur, për shkak të pasigurisë, në Kishën e Stubllës. Dihet se festa e shën Prenës festohet më 26 qershor. I tërë populli i Karadakut, edhe nga pjesët e Maqedonisë dhe të Kosovës, drejtohet në këtë ditë për Dunav për nder të kësaj feste për t'iu lutur shën Prenës. Dhe dihet po ashtu se edhe pjesa e Kratovës shkon edhe sot e kësaj dite e lutet në këtë kishë, jo ditën por natën (që mos të shihen).

Pasi që kemi përpara edhe bibliografinë mbi Stubllën, po shënojmë vetëm disa emra vendasish e shqiptarësh, dhe, poashtu, të huaj që janë marrë me këtë temë. Studiues vendas që janë marrë me disa aspekte studimi mbi këtë vend janë: Don Gjergj Gjergji-Gashi, pastaj don Nue Gjergji⁹, Isak Ahmeti¹⁰, Franë Gjergji,¹¹ Engjëll Koliqi¹², Sarë Gjergji¹³, Engjëll Sedaj¹⁴, imzot Mark Sopi¹⁵, Don Damjan Kurti¹⁶, Krist T. Ramaj¹⁷, don Mikel Tarabulluzi¹⁸, don Nikollë

Nazareku¹⁹, Don Jak Prenku²⁰, don Shan Zefi²¹, Don Rrok Gjonleshaj²², Qeshk Ukaj²³, Gjon Ballabani²⁴, don Lush Gjergji²⁵, Zef Ahmeti²⁶, Don Agim Qerkini²⁷, Don Fatmir Koliqi²⁸, Pjetër Gjoni²⁹, Ndue Ukaj³⁰, Albert Ramaj³¹ etj. Studimet a punimet e këtyre që i përmendëm, kanë karakter historik, edukativ, etnografik, letrar, artistik, arkitektonik, gjeografik etj. I shënuam famulltarët e këj vendi sikur vendas, por ata janë tjetër kund të lindur, por të cilët kanë vepruar ose ende veprojnë në Stubëll, si Dom Mikel Tarabulluzi, Dom Nikolla Mazrreku, Dom Rrok Gjonleshaj, kurse imzot Mark Sopi dhe Dom Damjan Kurti janë të lindur në Binqë. Këto dy famulli janë mbajtur përherë sikur të ishin një, pasi që edhe të dy këto vende janë pasardhës të martirëve dhe familjarisht janë shumë të lidhur mes veti. Kurse Dom Shan Zefi është i famullisë së Stubllës (i lindur në Dunav).

Shumë rreshta, punime dhe libra të publikuara në gjuhën shqipe janë nga autorët shqiptarë si: Atë Gjergj Fishta, Atë Justin Rrota e At Marjan Prela³², imzot Lazer Mjeda³³, Jashar Rexhepagiq³⁴, Gaspër Gjini³⁵, Zef Mirdita³⁶, Dhimitër S. Shuteriqi³⁷, P. Vinçec Malaj³⁸, Sadullah Brestovci³⁹, Anton Dedaj⁴⁰, Stavro Skendi⁴¹, Drita Halimi-Statovci⁴², Jahja Drançolli⁴³, Nuri Bexheti⁴⁴, Sabit Jaha⁴⁵, Frrok Kristaj⁴⁶, Tefik Basha⁴⁷, Rexhep Doçi⁴⁸, Rexhep B. Demiri⁴⁹, Uran Asllani⁵⁰, Rexhep Munishi⁵¹, Mehmet Halimi⁵², Muhamet Halimi⁵³, Ismail Syla⁵⁴, Hysen Matoshi⁵⁵, Mujë S. Berisha⁵⁶, Shefki Sejdiu⁵⁷, Albert Prestreshi⁵⁸ e shumë të tjerë. Do theksuar se nuk janë të shënuar shumë emra nga Shqipëria që kanë trajtuar apo e trajtojnë Stubllën drejtpërdrejt apo tërthorazi edhe sot në punimet të tyre. Për këtë shpresojmë se do ta bëjmë në një shkrim të veçantë.

Duhet gjithsesi të theksojmë se edhe joshqiptarëve ky vend ua tërhoqi vëmendjen, e sidomos historia e Stubllës, ashtu sikundër ua rëheq vëmendjen edhe e tashmja. Këta studiues janë: Georg von Hahn⁵⁹, Georg Rosen⁶⁰, Jean-Claude Faveyrial⁶¹, Fulvio Cordignano⁶², imzot Fulgenz Carev⁶³, F. Fougeray⁶⁴, Hillero⁶⁵, Troveyriot⁶⁶, motra Lesuer⁶⁷, Franjo Djuric⁶⁸, Alois Turk⁶⁹, Andrija Nikic⁷⁰, Atanasie Urošević⁷¹, Georg Stadtmüller⁷², Peter Bartl⁷³, Ger Duijzings⁷⁴, Noel Malcolm⁷⁵, Robert Elsie⁷⁶, Valentino Savoldi⁷⁷, Ni-

kola Zutic⁷⁸, dhe kohëve të fundit institutet e ndryshme që merren me çështje nukleare si psh.: “Vinca” Institute of Nuclear Sciences, Beograd; CRR (*Regional Centre for Radioactivity of Veneto*) - ARPAV, Verona, Itali; NRPA (*Norwegian Radiation Protection Authority*), Norvegji; SSI (*Swedish Radiation Protection Institute*) Stockholm, Suedi; UCD (*University College of Dublin*), Physics Department, Dublin, Irland. Bëhet fjalë konkretisht për uraniumin që është argumentuar se ka sasi shumë të madhe në Stubëll; sipas tyre është vendi i dytë me sasi të madhe në krejt ish Jugosllavinë që ka uranium (uran), sidomos në kodrën Stubllavaqa që është rreze e këtij fshati (shif shkrimin e këtyre institucioneve bashkangjitur në libër).

Arsyja që gjithë këta njerëz u morën dhe ende merren me të kaluarën dhe me të tashmen e këtij vendi, janë ngjarjet që ndodhën gjatë historisë së Stubllës dhe rrethinës, si është, në radhë të parë, internimi i popullatës nga Stublla, Terzijajt, Binça, Vërnakolla për në Turqi - maltretimi e martirizimi i tyre për shkaqe sidomos religjioze e etnike. Është shumë e rëndësishme në trajtimet e këtyre autorëve edhe shkolla e Stubllës e vitit 1905.

Nuk duhet të anashkalohej edhe një fakt, se për Stubllën luante një rol të rëndësishëm pozita gjeografike në afërsi të Letnicës, famulli e njohur për shtegtim jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë ku lavdërohet (e lavdërohej) edhe shenjtërorja e ipeshkvisë së Kosovës. Deri më 1905 Stublla ishte një famulli e përbashkët me Letnicën. Pra, për shkak të pozitës gjeografike në afërsi të Letnicës, ndodhi shpesh që ky vend të bëhej i njohur në tërë trojet shqiptare dhe më gjerë. Kjo vërehet qartë nga publikimet e mëhershme në gjuhën shqipe e, po ashtu, edhe nga ato të huaja.

Arkivet e shumta që gjenden në shtetet evropiane, kanë dokumente që mund që ndryshojnë dhe t'i përmirësojnë rreshtat e historisë, jo vetëm të Stubllës, por edhe të vetë popullit shqiptar. Sidomos ato për kulturën, për rrethanat shoqërore të kohëve ta caktuara, për etnografinë, religjionin dhe bi(bli)ografinë.

Përveç Vatikanit, Vjena është një ndër qendrat kryesore për hulumtimin e historisë dhe historiografisë shqiptare. Që prej vitit 1994 kam gjurmuar e gjurmoj nëpër arkivat austriake, kurse me

bi(blio)grafinë e Stubllës edhe më parë. Hulumtimet që janë bërë në arkivat austriak, e kanë të bëjnë shumë me fshatin Stubëll dhe me shkollën e saj dhe po ashtu, edhe me disa vende të këtij rajoni.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të shënojmë dokumentacionin, i cili gjendet në arkivin shtetëror të Austrisë e që ka të bëjë drejtpërdrejt me fshatin Stubëll e me banorët e saj, apo edhe tërthorazi bashkë me këtë rrethinë. Pra, dokumentacionin që do ta shënojmë më poshtë, është vetëm një pjesë e jo i tërë dokumentacioni që gjendet në këtë arkiv. Edhe pse një pjesë e dokumentacionit arkivor është tashmë i njohur për studiuesit tanë, të cilën e ka përpunuar studiuesi i thukët për këtë vend, Dr. Don Gjergj Gjergji-Gashi, megjithatë ka ende dokumentacione që nuk janë fare të njohura për publikun.

Ka studime të veçanta që në gjuhë të huaja janë të botuara mbi këtë fshat dhe për personalitet e këtij vendi, si psh. albanologu më i shquar i shekullit të kaluar, Georg von Hahn, i cili ka bërë e studime për këtë vend dhe i ka publikuar në gjuhën gjermane. Pastaj qysh më 1917 kemi publikime në Vjenë në gjuhën gjermane nga studiues austriako-hungarezë mbi don Zef Ramajn dhe Don Mikel Tarabulluzin. Më vonë kemi studiuesin e historisë shqiptare, Georg Stadtmüller, i cili një pjesë të studimit të vet ia kushtonte këtij vendi, si dhe studiuesin bashkëkohor, Peter Bartl. Kurse për shkrimet në gjuhën italiane, janë të njohur Aldonde Aldegheri, Fulvio Cordignano. Ndërsa në atë angleze njihet studiuesi bashkëkohor, Ger Duijzings, pastaj edhe Noel Malcolm. Të gjithë këta i kanë dhënë një publicitet të mirë në tërë botën martirëve të Stubllës të vitit 1846-48.

Shtrohet pyetja: çka ka në arkivin e Vjenës për këtë vend dhe rrethinë? Një përgjigje e shkurtër do të ishte: dokumentacion i mjaftueshëm, sa që nuk mund as të paramendohet për këtë vend “të vogël”. Të shkojmë me radhë.

Pjesa e parë ka të bëjë me personalitetin e këtij rajoni me dokumente që ngjallin shumë interesim në këtë arkiv, për priftin e lindur në famullinë e *Zarnagoria di Scopia* – Letnicës – don *Tomë Raspasani*, për të cilin deri më tani pak kemi ditur për jetën e tij.

Do të sjellim disa të dhëna biografike mbi priftin nga Karadaku, Tomë Rraspaskanin, të cilat të dhëna do t'i shënojmë këtu. Për këtë ne vumë kontakt edhe me famullinë në Hungari, aty ku ai kishte shërbyer me vite të tëra dhe na informuan më gjerësisht për jetën e tij atje, ku edhe vdes. Ne i shkëmbyem materialet që kishim për të, sepse as arkivi në Hungari nuk kishte informacione të plota për jetën e tij në ipeshkvinë e Shkupit dhe nuk kishin qenë në dijeni se ai ishte nga Kosova, konkretisht prej Karadakut.

Raportet mbi Tomë Rraspaskanin ruhen në arkivin shtetëror të Vjenës dhe janë të botuara nga Ignac Zamputi. Kurse kohëve të fundit Nuri Bexheti ka bërë një hulumtim (doktoranturë në Universitetin e Vjenës) shumë të thukët mbi kohën e Rraspaskanit, dhe ka shumë gjëra që cekën mbi Tomën. (shih bibliografinë)

Pjesa e dytë ka të bëjë me martirët e Stubllës, Terzijajve, Binçës, (për martirët e Karadakut apo Malit të Zi të Shkupit, si quhen nëpër studime të ndryshme) të vitit 1846-1848. Këto dokumente i ka hulumtuar më së miri deri më tani Dr. Don Gjergj Gjergji, ku një pjesë të tyre i ka botuar në librin e tij të njohur “*Martirët shqiptarë gjatë viteve 1846-1848*”.

Mbi Stubllën si famulli dhe shkollën e saj të parë në gjuhën shqipe, pos dosjeve të tëra, shumë të pasura me akte dhe me informacione; ekzistojnë edhe letrat e mësuesit të kësaj shkolle, Don Mikel Tarabulluzit, si dhe personalitetet e Stubllës, që kanë lindur këtu në Stubëll dhe kanë vepruar diku tjetër si: *Fratel Zef Antoni* (Antunoviq), *don Zef Ramaj*, *Atë Franë Koliqi*, *Dile* (Protegjena) *Bekaj*, *Marie* (Sherlotë) *Demaj*. Këto personalitete për opinionin janë ende të panjohura, të cilët, në fakt, ishin shumë të angazhuar në jetën kulturore, shoqëro-politike, humanitare, religjioze-kombëtare shqiptare dhe më gjerë etj.

Pjesa e tretë ka të bëjë me personalitetet nga Stublla, me shkollën në Stubëll dhe me rrethinën e këtij vendi. Sa për dijeni, don Zef Ramaj ishte i angazhuar, sipas disa dokumenteve, edhe për pavarësinë e Shqipërisë më 1912, kurse P. Franë Koliqi (1873-11.10.1919) (mund të shkruhet edhe forma e emrit Françeshk) ishte i lidhur ngusht edhe me P. Shtjefën Gjeçovin dhe kanë vepruar së bashku, pasi që të dy ishin françeskanë të provincës shqiptare. Atë Frana një kohë ka vepruar si mësues në Zym të Hasit, çka dëshmo-

jnë edhe letrat e tij të shumta dërguar ministrisë mbretërore të monarkisë Austro-Hungareze dhe po ashtu dëshmon fakti se në botimin e parë të veprës “Kanuni i Lekë Dukagjinit” të atë Gjeçovit, përmendet qysh në fillim të kësaj vepre (botimi 1933 fq. XV) nga Pashk Bardhi edhe frati nga Cërnağora (Stublla) atë Fran Koliqi.

**I. INFORMACIONE DHE DOKUMENTE NGA
ARKIVI SHETËTOR I AUSTRIË (VJENË)
DHE STUBLLA ME RRËTHINË**

I. 1. Tomë Rraspasi

Që në fillim le të theksojmë një dëshmi të re, se prifti dhe organizatori i njohur Tomë Rraspasi (*Raspasari apo edhe Raspisari e Rraspanovich*), prift, organizator dhe bashkëkohanik e mik i Pjetër Bogdanit⁷⁹ ishte nga Karadaku. Në shumicën e rasteve të publikimeve të deritanishme shënohet se vendi i lindjes së tij ishte Janjeva, Prishtina, Prizreni, Novobërda apo diku tjetër, por asnjë nga këto të dhëna nuk janë të sakta - vendlindja e tij është famullia e Letnicës.

Për ta dëshmuar mëtimin tonë, le të cekim dokumentet e kolegjit ilirik të Loretës ku thuhet me sa vijon: ““*Adi primo Gennaro 1665. TOMASO RASPASANOVICH di Letniza in Serrvia. Venne in luogo di Vincenzo Mattevich per il luogo di Uscopia mandato da Mons.r Ariv.o Andrea Bogdano. Ma perche erano erano passati li sei mesi della vacenza, e toccava l'elezione non più all'Arcivescovo, ma al Cardinale Protettore. Fu per tanto amesso per special gratia di S.E. come dall'infra scritta copia di lettera appare. E d'anni 14 e senza prima Tonsura. Ha Studiato li principij della Gramatica. Non sa Italiano. Parla dene la lingua Turchesca, et Illirica. Ha portato il solito deposito di scudi 10. Di Fori: All' Ill.mo et M.to Monsi.re Othone. Loreto. Di Trento. Ill. mo et M. to Revd. O Sig.re. Considerando la spesa e gl'incomondi del viaggio sofferti per cosi lungo camino da Tomasso Rraspanovich ch'è socta venuto per riempiere il luogo d'alunno spettante all'Archivecovo di Scopia, ma non e giunto in tempo dei sei mesi assegnati per la di lui nominatione, condescendo in fargli io la pgratia del medesimo luogo in nome del Sig.r Cardinal Antonio Protettore, non per modo di reintegrarlo dela nomin a pedruta dall'Arcivescovo sud.o ma per gratia speciale, e dipendente dall'assoluta libertà e faculta che sopra il medesimo luogo ha acquistata Em.za in Virtù della Bolla della S. Mem. Di Vrbano ottavo, potra dunque V.I. riconsocere i requisiti che cha se siano capaci, e fare che sominci dal primo di questo messe e di questo Anno a godere come Alunno della gratia sudetta, et a V.I.m'offerò con tutto l'animo. Roma li 6 Gennaro*

1665. Di V. I. Affet.mo per servirla Il Card. Carlo Barberini. Adi 5 Luglio 1665. fece il solito Giuramento. Adi 3. 9bre 1667. passo alla Filisofia, havando fatto nelle lettere humane competente profitto. Adi 3. 9bre 1670. passo alla Teologia Scolastica, e Morale. Adi 20 Desembre 1671. si ordino Suddiacono. Adi 26. Aprile 1672 parti. S'e portato bene. Sa bene; benche dalla Scolastica non hà potuto haver tutte le Materie, non essendosi compito il Corso, per mancanza di soggeti. Habile ad ogni ministero Ecclesiastico, con talento di predicare. Sano (44v).⁸⁰ ...

Në shqip: *Toma Raspasanovic nga Letnica. Në kolegji arriti më 1.1.1665 në vend të paraparë për argjipeshkvinë e Shkupit. Para ardhjes së tij ishte në kolegji ishte Vinko Matevici. Me urdhrin e argjipeshkvit Andrea Bogdani, Toma erdhi në kolegji edhe pse kaluan gjashtë muaj dhe vendi i zbrazët ishte për ipeshkvinë e Shkupit. Toma erdhi me ndihmën e kardinalit mbrojtës. Toma pati. Toma pati 14, tanzurën e parë e parë ende nuk e kish pranuar. Është regjistruar në klasën e parë të gjimnazit dhe nuk njihje gjuhën italiane. Mirë e fliste gjuhën turke dhe ilire (gjuhën serbo-kroate). Menjëherë në depo i dha 10 skuda. Këtë shumë ia dorëzoi administratorit të qytetit të Loretos Ottonit.*

Para se të vinte në Loret, Toma ishte në Romë. Nga Roma erdhi më 6.1.1665 e kishte dhënë betimin. Më 8.IV. 1665. Augustini Franciatti, argjipeshkvi i ceratisontes të shtunën e madhe ia ndan katër rende të ulta. Studimet e filozofisë e kreu më 3.II.1667 dhe kështu tregoi sukses të mirë. Rendin e subxhakonit ia ndau monsinjor Burani, argjipeshkëv administrues dhe vizitator i vendeve që nuk besonin. Toma subxhakonin e pranoi në kapelën e kolegjit ilirik. Teologjin morale dhe skolastikën e kreu më 3.II. 1670, ndërsa më 26.IV. 1672 shkoi nga kolegji. Ka qenë i sjellshëm, i shëndoshë, i arsimit dhe predikator i mirë. Ishte i afirmuar dhe i aftë për çdo funksion kishtar⁸¹.

Të njëjtën e thotë dhe e cek edhe studiuesi Malcolm⁸². Këtë mund ta dëshmojë edhe një fakt tjetër, kur bëhet fjalë për Gjon Raspasanin nga Karadaku.⁸³ Për biografinë e Tomës mund të gjejmë gjëra me interes edhe në veprën Odette Marquet, “Pjetër Bogdani Letra dhe dokumente”.

Në arkivin e Vjenës ka po ashtu shumë dokumente mbi Tomë Rraspaskanin, siç janë sidomos protokollat e publikuara nga Injac Zamputi dhe Selami Pullaha. Siç e cekëm më lart, në mënyrë intensive e sistematike ka punuar Dr. Nuri Bexheti - për veprimtarinë e T. Rraspaskanit ai ka shkruar edhe në disertacionin, përkatësisht mbi “Luftrat turko-austriake mes 1683-99”, ku rol të rëndësishëm kishin Gjeneral Veterani dhe Tomë Rraspasi⁸⁴. Duhet cekur se Toma që përherë ceket si *vicarus*, që prej fillimi të shekullit XVII ishte larguar nga Kosova dhe qëndronte në Hungari. Kishte shërbyer si prift në Budapest të Hungarisë që prej janarit 1702 deri në vdekje më 31 maj 1718.

Gjatë hulumtimeve mbi Tomë Rraspaskanin, duke iu falënderuar z. Andras Koltai, arkivistit të arkivit të Piastrëve në Budapest të Hungarisë, na siguroi disa informacione shumë të rëndësishme mbi jetën e Tomës në Hungari. Të njëjtën kohë edhe ne i dhamë informacione për jetën e tij gjersa ishte në ipeshkvinë e Shkupit, pra në territorin e sotëm të Kosovës.

Sipas Arnold Schoen, thuhet se Rraspasi ishte me prejardhje italiane dhe ishte prift petrin. Priftërinjtë petrinë, sidomos në shekullin e 16 e 17, ishin priftërinj oborrtarë apo priftërinj shumë të respektuar nga aristokracia dhe kishin një kulturë të gjerë jo vetëm teologjike. Kurse Tomë Rraspasi, sipas kësaj titulli, ishte shumë i privilegjuar. Ai vazhdon më tutje se Rraspasi kishte ardhur me motrën e vet, Katarinën, në Hungari dhe me djalin e vëllait të vet, Antonin. Risia e kësaj informacioni qëndron në faktin se zbardh pyetjen lidhur meçështjen se a kishte pasë me vete Toma besimtarë nga ipeshkvia e Shkupit apo jo. Nga dëshmia del se besimtarët katolikë nga Kosova kanë ikur edhe drejt Hungarisë në kohën kur edhe vetë Toma largohet. Schoen potencon po ashtu, se Toma ishte i formuar shumë mirë, jo vetëm në aspektin religjioz-teologjik, por edhe atë edukativ, shpirtëror dhe kishte prirje të ndryshme për art, se shtëpia e tij ishte me piktura të ndryshme jo vetëm me motive religjioze, por edhe me motive të natyrës. Edhe nga *Budapest Fovaros Leveltara* (Archiv i kryeqyteti të Budapest shënohet, sipas *Miscellanea nova*, Fasc. 3) (për)shkruhet se Tomë Rraspasi kishte disa piktura artistike që i posedonte e që ishin me motive të ndryshme: Kryqë-

zimin me një postament të zi, Shën Barbarën, Shën Injac Lojolën, Shën Françesk Ksaverin, motiv nga kalvari, mandej motive si Shën Ana, Shën Gjon Nipomuzzeni, Shën Gjergji, Shën Antoni i Pado-vës, engjëlli, dhe po ashtu piktura me motive të natyrës.

Motrat e para që erdhën në Stubëll ishin nga Sllovenia : m. Svetomira Polda, m. Karmela Benko dhe m. Jerneja Novljan. Këto motra njihnin edhe barërishtat që mund të përdornin për sëmundje të njerëzve e që mund të gjindeshin në zonën e Karadakut, kështu që edhe atë pasuri natyrore e shfrytëzuan sipas mundësive.

Në kujtesën ende të freskët është motra Himelina Drenik. Më 1980 shkruan për laramanët e Karadakut se edhe sot e kësaj dite ata janë përherë që vizitojnë ambullancën e Stubllës për nevoja të ndryshme. Sidomos gratë tregojnë shpesh dhe thojnë se “ne në shtëpitë tona jemi katolike”. Është itneresant të thuhet se gratë dhe femrat laramane apo myslimane të anës së Karadakut, nuk kishin aq shumë besim tek mjekët për ti vizituar për ndonjë kontrollë mjekësore, por besim dhe mbështetje të plotë kishin në motrat vinçenciane dhe shpesh ishte shkak që ato i vizitonin. Për festa blejmë qirinjë, por ruhem i që mos të na shofin fqinjët tanë. Dhe i kemi poashtu dy emra, një të krishterë e një mysliman. Shkojmë fshehtas

në Kishë, sidomos për festa të mëdhaja”. Dhe vazhdon ajo se si tregojnë gratë gjatë mjekimeve që bënin në këtë ambullancë se edhe fëmijët e tyre i edukojnë në të njëjtën gjë sikur fet, pra edhe në fenë krishterë edhe atë myslimane, por poashtu i mësojnë që mos të flasin me dikë tjetër për këtë punë.

Ajo tregon një rast se si një herë një grua e re kishte ardhur 3 orë këmbë për të sjellur fëmion e e vogël tremuajsh dhe që ishte shumë i sëmurë. Ajo kishte udhëtuar 13 kilometra këmbë për ta ardhur tek ambullanca në Stubëll. Por ishte e kot, sepse foshnja e fogël ishte ishte në gjendje shumë të keqe. Dhe motra i tregon se për këtë foshnje ishte vështirë që të bëhet më diçka. Por e ëma i tregon se ajo është laramane dhe e pyet m otre se a bënë që të shkon me fëmijë në kishë dhe të thirrte priftin e atyshëm që fëmion ta bekon apo ta pagëzon, së paku ajo këtë dëshirë e kishte që fëmiu i saj të vdes si i krishterë. Meshtari i Stubllës shkon dhe e pagëzon fëmion, siaps dëshirës së nënës së tij, thu pas pagëzimit fëmiu vdes. Nëna e gjorë, ishte e kënaqur me këtë akt dhe thërret: Zot i dashtun, fëmiu shkoi në parajsë” dhe këhstu së paku një pjesë e dhëmbjës së shpirtit të saj u zbut, pasi kishte pagëzuar fëmion.

Është e ditur shpesh se fëmijët ishin pagëzuar nga nënat e tyre, pa dijeni të babait, nese në asi raste nëna ishte laramane e babai muslian, nuk guxonte ti tregonte kurrë për këtë punë. Kurse, kur të dytë prindërit ishin laraman, ata që të dy ishin të pajtimit të pagëzonin fëmion e vet.

Nuk duhet harruar se edhe motra Otilija Krämer në Dunav ka shërbyer shumë për gratë laramane dhe për popullatën laramane.

-
- ¹ GASHI Gj. Kosova Altari i Arbërisë, II, fq. 35.
- ² GASHI Gj. Kosova Altari i Arbërisë, II, fq. 66-67.
- ³ DJURIC F.: Die geschichte fq. 198-216
- ⁴ ZUTIC Nikola: Rimokatolicka misija i klerikalizam na Kosovu, fq. 108
- ⁵ GjERGJI Sarë: Laramanizmi (në Karadak), fq. fq. 115-116.
- ⁶ DJURIC F.: Die Geschichte der Krypto-Katholiken, fq. 204
- ⁷ DJURIC F.: Die Geschichte der Krypto-Katholiken fq. 204
- ⁸⁸ Shih. KRONIKU, in: Drita XV, 11-12 (107), 1984, fq. 8-9.
- ⁹ Krahaso DJURIC F.: Die Geschichte fq. 134-136 dhe Blagovest, (Shkup) 1933, Nr. 3, prill – maj.
- ¹⁰ Kraha. Djuric, F: die Geschichte fq. 180-187.

IV. BIBLIOGRAFI INTERESANTE

IV. 1. Hylli i Dritës

Hylli i Dritës flet edhe për P. Fran Koliqin, XI, nr. 2, 1935 fq. 55, kurse për Stubllën dhe Atë Anton Maroeviqin, Karadakun, Letnicën e Janjevën flet po ashtu te Hylli i Dritës dom Ndre Mejda, vëllai i argjipeshkvit të Shkupit, në XI, nr. 1, 1935, fq. mbi një diskutim që është bërë nëpër debatet sllave dhe shqiptare në rastin e shkrimit të Filip Fishtës në dy numrat e mëparshëm të këtij shkrimi mbi argjipeshkvijtë e Shkupit.

IV. 2. Johann Georg von Hahn mbi Stubllën dhe kriptokrishtenizmin

Një ndër studiuesit e thukët të historisë shqiptare është diplomati dhe konsulli austriak, Johann Georg von HAHN, i lindur më 11.07.1811 në Frankfurt a. M. dhe vdes më 23 shtator 1869 në Jena. Ai në librat e tij “Albanesische Studien“ dhe “Reise von Belgrad nach Salonik dhe Reise durch die Gebiete von Drin und Wardar” bën fjalë edhe për Stubllën dhe Karadakun. Në “Albanesische Studien” nuk jep informata të sakta për martirët e Karadakut, vetëm që e cek gjendjen makabre për martirët e Karadakut në afërsi të fshatit Gjilan. Kurse në librin “Reise von Belgrad nach Salonik” jep informata më të hollësishme për Stubllën. Në librin e fundit edhe njofton se Stublla kishte atëherë

40 shtëpi, kurse Binça 25. Po ashtu edhe të dhënat për martirët e Karadakut dhe mbi Atë Anton Moroieviqini i shënon Georg von Hahn. Kurse në librin “Reise durch die Gebiete von Drin und Wardar” vetëm i cek në faqen 334 pak informata për ipeshkvinë e Shkupit dhe po ashtu për famullinë e Karadakut. Në librat e tij ngjallin interesim hartat e rëndësishme, të cilat i shënojnë të gjitha vendet e këtij rajoni. Duhet pasur parasysh se të dhënat e Hahn-it janë bërë pak kohë pas kthyrjes së martirëve në vendlindjen e vet, sepse ai i boton këto dy vepra më 1854, 1861 dhe 1867, kështu që sigurisht përgatitja për botim e këtyre librave kushtonte kohë të gjatë në atë kohë. Hahn në librin e dytë përshkruan gjendjen e kriptokatolikëve dhe gjendjen e mjerueshme të tyre, jo vetëm në Karadak, por edhe në rrethinën e Prizrenit. Udhëpërshkrimi i tij në këtë rajon, jo pra vetëm për Stubllën, por gati për çdo fshat, jep informata, sado të jenë të vogla, janë me rëndësi, sepse janë të asaj kohe. Librat e J. G. von Hahn gjenden si në bibliotekat e ndryshëm austriake dhe janë abetare për studiuesit që dëshirojnë të merren me historinë, kulturën apo etnografinë shqiptare të shekullit 19. Hahn shkruan kështu: *In Mittelalbanien und dein Westen von Nordalbanien (dem Paschalik von Skodra) gibt es keine geheimen Christen; dagegen finden sie sich in dem Paschalik von Prisrend so zahlreich, dass die Gesamtzahl der dortigen Kryptokatholiken auf nicht weniger als 8000 Seelen angeschlagen wird. Ihre Abstammung nach sollen sie meistens Albanesen und nur einige im Norden des Landes gelegene Dörfer slavischen Stammes sein. Zu letzteren gehört das Dorf Gilani, welches durelt das Schicksal*

seiner Bewohner eine traurige Berühmtheit eriangt hat, denn diese wurden bekanntlich wegen ihres öffentlichen Rücktrittes zur katholischen Kirche unter schauderhaften Misshandlungen nach Asien geschleppt, von wo kaum die Hälfte nach ihrer Heimath zurückkehrte, nachdem es endlich den Bemühungen der Diplomatie gelungen war, von der Pforte die Erlaubniss hiezu zu erwirken, — denn die grössere Hälfte war den Misshandlungen während des Transportes und dem ungesunden Klima ihres Verbannungsortes erlegen. (Albanesische Studien, fq. 18).

Zur Pfarrei von Janjewe gehören vier katholische Häuser in Prishtina und 28 kryptokatholische Familien, dass heisst solche, welche im öffentlichen Leben für Muhammedaner gelten, obwohl sie sich im geheimen zum katholischen Glauben bekennen. Die zwei katholische Pfarrei des Bezirkes von Gilan liegt im Südön von Janjewe auf dem nördlichen Abhange es Karadag. Der Pfarrort ist das etwa sechs Stunden südlich von Gilan gelegene Dorf Letnitza mit 25 katholischen Häusern. Zu demselben gehören die Dörfer Schaschare mit 40 Häusern, Stubla, etwa eine Stunden süöstlich von Letnitza, mit 20 Häusern, zehn Minuten davon Wrnawakolo mit 10 Häusern, und eine Viertekstunde von diesem Wernesa mit 6 Häusern, anderthalb Stunden von Stubla Deps mit einem Haus, und Bintscha, zwei Stunden westlich von Stubla, mit 5 rämisch-katholischen und 22 griechisch-katholischen Häusern. Die Zahl der Krypto-Katholiken ist in dieser Pfarrei bedeutender, 17 Familien derselben haben erst vor einigen Monaten ihre katholische Confession vor der türkischen Behörden in G ilan

erklärt und sind von derselben anerkannt worden. Diese 17 Familien gehören zu dem Geschlechte der 25 Familien, welche vor etwa 15 Jahren bei gleicher Veranlassung sammt ihrem Pfarre Don Antonio Marawich aus Lesina nach Brussa geschleppt wurden. Von diesen, 184 Köpfe zählenden 25 Familien kehrten nach vierjährigen Exile 75 Personen in ihre Heimath zurück, die übrigen waren den Drasalen des Exils erlegen. Sie stammten aus den Dürfern Stubla, Bintscha, Wernawakolo und Wernesa. Es ist dies eine herzerreissende Geschichte, doch wozu verharrschte Wunden aufreissen, nachdem die Zeiten so viel milder und solche Vorfälle unmöglich geworden sind?

Die Gesamtzahl der krypto-katholischen Familien in beiden Pfarreien soll sich auf nicht mehr als 250 belaufen, und die der im Gebiete von Prisrend lebenden wird auf 200, und in dem von Ipek auf 150 beschrenk. Dies ergäbe als Gesamtzahl der albanischen Krypto-Katholicken des Erzbistums Skopia¹ dessen Sitz seit Langem nach Prisrend verlegt wurde, die Summe von höchsten 600 Familien oder 3.000 Individuen, und anderwärts gibt es keine Krypto-Katholiken. Freilich spricht man in Skodra von der dreifachen Summe, aber ist denn Skodra der einzige Ort, wo die aus der Ferne zugebrachten Summen auf das Quadrat erhoben werden? Wir vermuthen im Gegentheil, dass selbst unsere Angaben noch überschätzt sind. Doch selbst, wenn sie genau sein sollten, so berechtigen sie dennoch zu der Frage, ob es, ganz abgesehen von dem Rechtspuncte, nicht in dem wohlverstandenen Interesse der Pforte liege, ihre Toleranzedicta auch gegen diese 3.000 Seelen in

Anwendung zu bringen, indem die ihr aus dem gegen dieselben geübten Glaubenszwang erwachsenden Vortheile in gar keinem Verhältnisse zu dem moralischen Schaden stehen, welchen ihr der selbe in der öffentlichen Meinung von Europa zufügt. Denn welches sind diese Vortheile? einige Recruten; und wie lange kann die ihren christlichen Unterthanen gewährte Militarfreiheit noch dauern? und würden diese 3.000 Individuen nach ihrem öffentlichen Bekenntniss zur katholischen Kirche nicht zu Kopf- und Kriegssteuer verpflichtet werden? Bedenkt man nun noch die grösseren Verlegenheiten, welche das früher erwähnte Vorgehen gegen die Krypto-Katholiken der Pforte bereitet hat, und die noch grösseren Verwicklungen, welche ihr eine Erneuerung desselben bereiten müsste, so können ihre aufrichtigen Freunde nur wünschen, dass sie ihre Beamten in den betreffenden Bezirken strengstens dazu verhalten möge, den öffentlichen Glaubenserklärungen dieser Krypto-Katholiken keine Hindernisse in den Weg zu legen. Doch haben, wie gesagt, die Behörden von Gilan bereits einen lobenswerthen Anfang in diesem Sinne gemacht; hoffen wir, dass auch die übrigen Bezirksobrigkeiten diesen Beispielen folgen werden. (Reise von Belgrad nach Salonik" Fq. 83-84).


Zwischen dem Jerrekaribache und Nosail mündet von Süden her das Thal von Rimnik. Das Dorf, mit 40 alban., 12 Zigeuner- und 2 bulgar. Häusern, liegt 20 M. von der Morawa entfernt, an der Spitze einer Thalabelung. In dem Östlichen Arme liegt 1 St. bachauwärts von Rimnik das katholischen Dorf Stubla, ziemlich

hoch am nördlichen Abgange eines rundes, aus der Karadagkette hervorragenden Gipfels. (Reise von Belgrad nach Salonik Fq. 170).

In dem Östlichen Arme liegt 1 St. bachauwärts von Rinnik das katholischen Dorf Stubla, ziemlich hoch am nördlichen Abgange eines rundes, aus der Karadagkette hervorragenden Gipfels. (“Reise von Belgrad nach Salonik” Fq. 172.)

*Wenn wir das sogenannte Montenegro als das erste albanische „schwarzen Berg“ annehmen, so wäre dies das zweite, und weiter südlich von demselben, der Stadt Diwra gegenüir, werde wir doch eine dritte Landschaft dieses Namens kenne lernen. (Ob der zwischen Prischtina und Komanowo gelegene und nur von Albanesen bewohnte Bergtrich Karadagh von diesen nicht etwas auch Mal in *çi* genant wird, konnte wir nicht erfahren) (Gebiete des Drien und Wardar, fq. 79.)*

Poashtu edhe në fund të librit të tij gjinden hartat ku shifet edhe Stublla (shif faksimilin).



IV. 3. Misionet flutarake (missione volante) të Jezuitëve (italianë) në Kosovë dhe në Stubëll 1888-1912.

Italinët organizuan në Kosovë prej 1888-1912 misione flutarake, të cilët shkonin nëpër famulli të Kosovës dhe predikonin ungjillin. Kështu ishin edhe në Stubëll. Po i sjellim vetëm shkurtimisht disa nga informatat për këtë punë. Një libër në gjuhën kroate “Jezuitët te populli shqiptar” është përgaditë nga autori i këtyre rreshtave dhe një pjesë të madhe ia kushton kësaj teme. Libri i është dorëzuar don Ndue Ballabanit në Zagreb dhe redaktorit Prof. Dr. Martin Berishaj në Lubljanë për botim. Pritet së shpejti ta shohë dritën e botimit.

Ne veprën e botuar në Venedit më 1898, që mban titullint “Lettere edificanti della Provincia Veneta (Serie IX) përshkruhen jezuitët që ishin misionarë (missione volante) në ipeshkvinë e Shkupit prej 3 tetor 1896 deri më 21 skurt 1897. Duhet cekur se në këto misione rolin kryesor e lunate p. Donnico Pasi dhe p. Giacomo Jung. Në një kapitull të këtij përshkrimi gjejmë poashtu edhe përshkrimin me shumë interes dhe vizitën e jezuitëve italianë që i kishin bërë Stubllës dhe Binçës dhe që kishin bërë përshkrime të popullatës së kë-tushme. Nuk e kishin të lehtë për misionarët italianë, sepse autoritetet turke i akuzonin se këta dëshirojnë të ndërtojnë kisha apo shkolla në këto vende.²

Poashtu edhe “Letter edificanti della Provincia Veneta Serie XVII” shkruar nga P. F. Genovizz, ngjall interesim se në këtë pjesë, po

ashtu, bëhet fjalë për Stubllën e viteve 1900-1901 në një kapitull të tërë. Bën fjalë edhe për Don Mikelin dhe për historinë e Zojës Cër-nagore. Mandej jepen disa shënime me shumë interes për kriptokri-shterët dhe për ngjarjet e ndryshme të asaj kohe e të këtij rrethi. Aty jepet një ngjarje domethënëse: një person nga Stublla e kishte fe-juar djalin e vet me një vajzë nga Binça. Kurse ajo vajzë më vonë kishte shkuar për motër të kishës (murgeshë) dhe kështu ishte pri-shur fejesa, ndërkohë që ky dëshironte ta vriste babanë e vajzës që e kishte lejuar vajzën e tij të shkonte për motër kishe (murgeshë).³ Në këto publikime ka edhe shumë materiale për laramanizmin në përgjithësi në Kosovë.

Me mjaft interes është edhe letra e Francesco Genovizzi, e shkruar më 28 janar 1912 dhe e botuar në “Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Veneta, Serie XXII⁴, Venezia 1913, fq. 3-20. Në të jepet tejet mirë një përshkrim mbi gjendjen e këtij rajoni, pra jo vetëm mbi famullinë e Stubllës dhe famullitarit të saj, Don Miekl Tarabulluzit, por edhe mbi gjendjen e shumë kriptokrishterëve në këtë rrethin të Karadakut. E thekson se në Stu-bëll kishin formuar kongregatën mariane më 1911, kurse në një letër të mëvonshme e përshkruan famullinë e Shkupit, misionet e mbajtura në këtë famulli, të cilat i kishte kërkuar famullitari don Zef Ramaj.

Vlen të theksohet se deri më tani përherë është menduar se rregulli jezuit brenda vetes nuk kishte shqiptarë nga Kosova si anëtarë të vet në këtë rregull dhe mendohej se i pari ishte P. Shtjefen Dodes nga Stublla (meshtar i lindur më 1975). Por sipas dokumenteve në

gjuhët e huaja: italiane, angleze, fraqeze, kroate; dihet se edhe fratel Zef ishte nga Stublla (shif kapitull në v ete për fratel zefin në këtë libër) dhe që ishte anëtar i rregullit jezuit. Pra, Zef Antunoviq ishte nga Stublla qe ishte jezuit, fratel. Në librin që autori ka përgatitur në gjuhën kroate mbi jezuitët, shënohen më detaj këto gjëra edhe. Po ashtu, nga Gjon Sinishta janë të publikuara në gjuhën angleze. Jezuiti i njohur Fulvio Cordignano në 3 pjesët e libravet të veta “L`Albania” shkruante për fratel Zefin nga Stublla dhe rolin e tij si misionar i misionit fluturues. Shif edhe sidomos pjesën e parë, kreu VI, nr 3 ku shkruan për rëndësinë e fratel Zefit.

IV. 4. Albanija i Macedonija - Jakov Sliskovic⁵

Në dokumentet e arkivit shtetëror në Vjenë, Jakov Sliskovic paraqitete si nacionalist i tërbuar kroat, gjatë kohës kur ishte mësues në Janjevë, kur kishte ardhur nga nga Sarajeva për t’iu dhënë mësim kroatëve në Janjevë. Mund të shihet edhe në dosjen e Janjevës dhe Letincës për këtë person kontravers. Është interesant të theksohet se Sliskovic kur flet për martirët e Karadakut, nuk cek se ishin shqiptarë, por thotë “litnicasit tanë” dhe kështu është vazhduar citimi mes kroatëve se ata ishin kroatë, sikur rasti i Nikola Colak dhe Ive Mažuran në biografinë mbi Javjevën botuar me rastin e 700-vjetorit të Janjevës.⁶ Sliskovic në librin “Albanija i Macedonija” shënon se martirizimi ndodhi më 1852 dhe ishin 280 familje. Këto të dhëna nuk qëndrojnë aspak siç shkruan Sliskovic, pra as viti as

familjet; nuk dihet se nga i ka marrë këto të dhëna, edhe pse ai jetonte në Janjevë.

IV. 5. Autorë të ndryshëm për martirët dhe atë Anton Maroeviqin

Është interesant se historiani fraqez Hecquard Hyacinthe (*Histoire et description de la Haute Albanie ou Gukgarie*. Paris 1858 , fq. 484-487) iu kushton rëndësi martirëve ta Karadakut në librin e tij „Histoire...“ Sipas njohurive të mia, është i pari person që publikon diçka në libër apo gazetë mbi martirët e Karadakut (këtu nuk hyjnë letrat që janë të shkruara, por vetëm librat apo revistat që kanë shkruar për këtë temë). Sipas Hyacinthe Hecquard ishin të internuar 120 familje dhe diku rreth 1000 shpirtëra (persona); kështi që është shumë për tu pyetur se me të vërtetë a ishin 120 familje dhe 1000 persona, apo ai kisht fjalën se në Karadaku ishin 1000 familje që ishin kriptokrishtere dhe një pjesë e vogël u internua për shkak se ishin deklaruar haotas të krishterë. Tek Hecquard është shumë itnereasnt se cek që edhe më 1849 ambasadori anglez duhej të intervenonte te Porta e lartë për përmirësimin e gjendjes së kriptokatolikëve të Karadakut që ishin kthyer nga internimi dhe të rregulloj edhe gjendja e pasurisë së tyre që turqit iu kishin marrë me zorë.

Shifet shumë qartë nga ky se stubllasit kishin ende probleme me pushtetiftn tur të asëaj kohe. Sistoriani Hecquard i jep poashtu rën-

dësi të madhe vet priftit të atëhershëm të këti rrethi, atë Anton Maroeviqit. Poashtu edhe aktivitetet dhe angazhimet e ambasadave angleze, fraqeze e austriake për ndihmë e tyre për lirimin e martirëve të Karadakut nga kthetrat turke.

Ka disa autorë të tjerë (edhe sipas Gjergjit-Gashit) që ishin të mendimit se Martirët e Karadakut nuk ishin në numër vetëm aq sa mendohej deri më tani, porse më shumë. Mendohej se ishin diku rreth 1000 martirë nga ky vend. Ndoshta janë të përzier disa gjëra me numrat, sa kriptokatolikë mund të kishin qenë në këtë rajon e jo martirë, po ashtu edhe SCHWEIGER-LERCHENFELD në librin e tij “Der Orient”, po ashtu ROSEN “Geschichte der Türkei”, Jastrebov në artikullin e tij “Nešto o Gornjoj Moravi”, pastaj edhe Tajani “avvenire dell’Albania”, etj. Për këtë ka bërë shënime edhe Gj.Gashi.⁷ Poashtu edhe autori Dr. Hadzi Vasilevic është i mendimit se ishin 1000 persona e 120 familje.

Nuk do të ishte keq të cekim edhe disa publikime që janë bërë qysh më herët për biografinë e Atë Anton Maroeviqit, sikur ajo nga kushëriri i tij P. Pijo Maroevic në revistën e Splitit “Narodna Svijest” me titull: “Zaboravljenoj uspomeni o Antun Maroevica, franjevca, misionara zupnika u Crnoj Gori blizu Prizrena, ispovjednika sv. Katolicke vjere”, të vitit 1926. Po ashtu, edhe shkrimi në revistën e ipeshkvisë së Dubrovnikut të XXVI, nr. 5-6, 50-52 me titull: “Progonstvo albanskih katolika pod muhamedancima”.

IV. 6. Në nder të Zojës Cernagore /n`Cërnagore

kem nji Nanë

Letnica është vend takimi jo vetëm për katolikët, por edhe për besimet e tjera, sikur ai mysliman dhe ortodoks. Po ashtu, edhe kombet tjera sikur shqiptarët, kroatët, serbët, romët, maqedonasit, malaziasit, vlehët dhe shumë banorë të vendeve të tjera të Ballkanit, janë përherë të pranishëm në festën e Ngritjes së Zojës Në Qiell më 15 gusht. Por është bërë po ashtu edhe vend takimi për ushtarët e ushtrisë shumëkombëshe në Kosovë dhe që pas kryerjes së detyrës së vet, vijnë me familjet e veta nga mbarë bota e përkulen para kësaj trupore. Po ashtu, edhe politikanët pa dallim feje dhe nacioni nga Kosova, vijnë e përkulen para kësaj trupore.

Është me interes të cekim se më 1962 u themelua nga Don Nikollë Mini revista ipeshkvore që mbante emrin „Zani i Zojës Cërnaqore“. Këtu shihet shumë qartë se çfarë rëndësie kishte Zoja Cërnaqore për ipeshkvinë tonë. Në këtë revistë është shkruar po ashtu edhe për Stubllën, sidomos: II, nr 3, 1963, fq. 24 ku është një letër e besimtarëve të Stubllës dhe shprehin shqetësimin se kishin mbetur pa famullitarë dhe fëmijët e kësaj famullie kishin përgatitë një dhuratë për Papën, që ia kishin dërguar ipeshkvit në Shkup për t' ia dërguar Papës në Romë për rastin e fillimit të Koncilit të II të Vatikanit. Po ashtu shkruan edhe në I. 2, 1962, fq. 21, II, 4, 1963, fq. 23.

Për ne këtu ka shumë rëndësi dhe tepër me interes, se muzika kishitare shqiptare (fjala është nga territori i Kosovës dhe Maqedonisë,



pra pa territorin e Shqipërisë, e të trojeve etnike shqiptare në të Mal të Zi), se të vetmen këngë që buron nga populli dhe që është në gjuhën shqipe origjinale, e kemi trashëguar deri më sot këngën që populli e njeh me titull “N`Cërnaqore kem një Nanë” dhe që buron nga ve-

të zemra e popullit. Këtë këngë e botoi për të parën herë poeti shqiptar, don Nue Bytyqi, famullitar i atëhershëm i Shkupit, te “Elçija e Zembrës së Krishtit” në Shkodër më 1894 me titull: “Kanga e popullit. N`nderr t`Zois Zernaghores”. Këtu po e sjellim versionin ashtu si e botoi don Nue Bytyqi dhe një version-translitterim që e ka bërë don Nikson Shabani për të mos ia humbur frymën origjinalit dhe për t’ia përshtatur muzikës-melodisë përkatëse të kësaj kënge. Kjo këngë duhet të jetë burim i banorëve të Karadakut.

Don Gaspër Gjini shkruan: ““ne kemi në gjuhën tonë edhe himnin e Zojës Cërnaqore. Dëgjohet nëpër kisha e shtëpi tona, por edhe me rastin e shtegtimeve në Letnicë. Nuk dihet se kur e ka fillimin ky himn i bukur, i cili tregon dashurinë e madhe ndaj Zojës. Gjatë shekujve është “pastruar” gjuhësisht disa herë. Ne e ruajmë si lutjen më të bukur që kemi, amanetin e stërgjyshve, të cilët në kushte tejet të vështira na e ruajtën edhe fenë shenjte. Koha është që edhe tani të mendojmë për “pastrimin” e këtij himni”.⁸

Kurse në revistën “Drita” të: X, 6, 1970, fq. 7, është botuar një shkrim (pa emër autori, por duhet të jetë Don Nikollë Mini autor i këtyre rreshtave), në të cili autori reflekton për këngën apo Himnin e Zojës Cërnagore, se këtu shënohet se janë 26 strofa, kurse kur numërohen dalin më shumë se 26, atë që Don Ndue Bytyqi ka publikuar:

„Poeti i moçëm popullor dhe i dëvoçëm i shkroi 26 strofa dhe kthesën, e cila përsëritet mbas çdo strofe....Melodia e kësaj kënge asht gjithashtu e moçme sa vetë kënga. Melosi asht i thjesht popullor, por tepër i bukur dhe i përshtatshëm ndjenjave që vetë poezia e shpreh gjatë 26 strofave të kësaj kënge...

Kjo është këngë shumë e njohur te populli i Kosovës, jo vetëm tek katolikët, por edhe te myslimanët, të cilët nëpër shtëpi të veta private e këndojnë në kohën e festave të Ngritjes së Zojës në Qiell, apo populli si e njeh me emër si: Zoja e Madhe apo Zoja Cërnagore që po e shënojmë këtu.

IV. 7. Kanga e popullit⁹ (Në ndeer të Zojës Cernagre)

(më poshtë kemi faksimil të këngës së popullit „N`Cernagore kem një Nanë“ dhe transiliterimin e don Nikson Shabanit)që publikoi për të parën herë poeti Dom Ndue Bytyqi, por kjo këngë këndohet me shekuj në popullatën e Karadakut, si tek të krishterët, poashtu edhe tek muslimanët.

KANGH POPUAIT

N' Nneer t' Eois Zernaghores

N' Zernaghore e kaem gni Naan
 Giza mscirir e dasetenii,
 T' hazens t'Eotit batavii
 I kaa hiret n'door to vet.
 Kesai t' bukur n' giza lulgimet,
 Kesai t'maz n' kvet t' dores
 I zoon Eoja e Zernaghores
 Me Fmii n' prehen sa' lezet.
 S' lumes Eoi e Birit t' sai
 I kioft landi n' mot e jot.

Kesni at Fmii me yres hainijet
 Saa lezetecem saat i sia,
 Per m' e dasetun giza na nuu,
 Semren giza po na e grabit.
 Nonsé fosegno, i maz n' dasetnii
 Po deri hire perni t' taan,
 Saa nner derte e t' vsetira jaan
 Ktu s lirohen per giza dit.
 Gheou, Scospnii, Scospnii fatmatae,
 Ci prei ciclet pate baftin
 Kio far Eoi me nghulun taftin
 N' tsa, me t' prue e me t' daal sot.
 Ató skrepa e male t' vsetira
 E kan nurrumun kreit kiefatin,
 E kan t' cives giza scshretin,
 Si parris me t' mira plot.

Uinat, kronat, malet vesum,
 Fuscut, kodrat e lulesame,
 Giza e' a' n' tok e azot to lume,
 Pastrin bora t' sai kazon.
 Pr' asi taftit n' rreco edritun.
 Derz pa pramun giza far hirit:
 Ata t' masit e fakirit
 Bose disciri nuk i sekon.
 Nner kaam t' sajn Scceptarija
 Prei giza ávot hapsceem nghusin,
 T' rrughes t' ghiatun nuk e másin
 Saa to maz do t' vuin siklet
 Me gui sepreos, ci s' jot e rrcóitun
 Gizaizili dertin kiann,
 Por si fmiya t' vetos man
 Ja eil semren giza kialmet.
 Ats i vorini e derdimeni,
 Vien i voriti e vien sakaté:
 E kni n' dery i á kputun setati,
 M' gui eás lópin t' giza derman,

Ulan n' ghiú jee skrehet n' vai
 Gnajo ghurc fmar per zot?
 Frsil i semers ju ka prae.
 Virgnes Naan i bié n' aman.
 Me fmii n' prehen áset e lkuur,
 Prma e jetes tai ju kput,
 Áset ars tietra me ju laut,
 Atii fosegno me i fal sennet.
 Gnajo tuab ci kiain e dnasin
 Pa ghuzun perpiet me kcor,
 N' molan t' zii, me t' n' lumes fmar
 Dorman lópin halit t' vet.
 M' gni faitoort no mui te Eoit.
 N' semer mause talas to fetili,
 Mkatit vet me i geet ansirir,
 Me i get nies jaan ars n' pennin.
 Jo: kio Naan s' um t' i perbus.
 Me i paitun discron me t' Birin,
 To giza unieses jan nep lirin
 T' lumes t' Eotit ja vazin.
 Derdimenit, nevoitarit
 Ja siks saat, jan ghon meledin,
 Dritan t' verbit, t' lighat semetin
 Comer-simsce ja diorghon.
 To sai Eumin t' mas tai s'irun,
 Me t' sain ui tai laglan balin,
 E kan pa' t' l'arghumun ha'in,
 Giza e mira s' ju vanon.
 Kuse me kóen discrote man
 I kien geeg si i pat rigaat,
 Kuse perpani dneste e nghraat
 Me fmii n' prehen ghettescem lot.
 Me fmii kputun giza moatit
 Pat ars man tai lotno,
 Tase po k'echet ghazemimus
 So si sekoi rigaja kot.

Per kuse unimé s'ik me toian
 Hivet t' kesi t' iunnescesces Eoit
 Nuk kaa neri men as ghoi
 Me i permun a dle e sim.
 Por san e dasetno, e harit, e nnel
 Áset kib e Luma per t' divoecm,
 N' hasmit tasem, e to mocem
 Kaa diftanun e' kaa cimrin.
 Me t' eil malet me ló n' á kise
 Kuse s' ghuzon, ali kretolmit
 Zuum me i bá, so t' giza renmit
 T' ramen báar n' ghaep e hick
 Ispaat hainit ei m' e desciu
 T' lumen kise gui heer ghuzene,
 Gnaní m' fiazin n' gak u becune,
 E paghuan me t' vsetirun dek.
 Ispaat zabat ci colamin
 Me i ramunum desctne vonnit,
 T' giza i elmi jascta yemnit
 E ne fuat to zee i nelot.
 Oh giza lavit, giza urini,
 Giza hat i kioft kasi Nano,
 Ci t' Scceptarijen nner giza ans
 Áset sáidlin, me unun, me ghoit.
 Dascetijen t' a pertrin
 Per koi Eoi Scceptarija maar,
 N' daset m' u rriit no kasan to paar,
 Scelbin vedi n' daset me igot.
 Sá, i mioser kuse kesi Xana
 N' vopra t' nesa i bín cimruos,
 E me nkat prop i pa boos
 Eamen t' Birit ja áceer rget.

B. Nee Batsci

? `CERNAGORE E KEM NJI NANË

1. N`Cernagore e kem nji Nanë

Gjith mëshir e dashteni,

T'hazens t'Zotit bytevi

I ka hiret n'dorë të vet.

2. Kësaj t'bukur n'gjithë lulzimet,

Kësaj t'madhe n'kyvet t'dorës

I thonë Zoja e Cernagorës

Me Fmi n'prehen sall lezet.

S'lumes Zojë e Birit t'sajë

I kjoft lavdi n'mot e jetë.

3. Kqyrmi at Fmi me rreze hyjnijet

Sa lezetshem sytë i sillë,

Per me dashtun gjithë na nillë,

Zemren gjith po na e grabit.

4. Ndonse foshnje, i madh n'dashni

Po derdh hire permi t'tanë,

Sa nder derte t'vështira janë

Ktu shlirohen për gjithë ditë.

5. Gzou, Shqypni, Shqypni fatmadhe,

Që prej qiellit pate baftin
Kjo far Zojë me ngulun taftin
N'ty, me t'prue e me t'dalë zot.

6. Ato shkrepa e male t'vështira
E kanë nrrumun krejt kiafetin,
E kanë t'qilles gjithë shyhretin,
Si parriz me t'mira plot.

7. Ujnat, kronat, malet veshun,
Fushat, kodrat e lulzume,
Gjith çka asht n'tokë e thot të lume,
Pastrin bora t'sajë kalxon.

8. Pra asi taftit n'rreze zditun
Derdh pa pramun gjithfarë hirit:
Aty t'madhit e fakirit
Bosh dishiri nuk i shkon.

9. Ndër kamë t'saja Shqyptaria
Prej gjithë anvet hapshem ngasin
T'rrugës t'gjithatnen nuk e masin
Sa te madh do t'vujnë siklet

10. Me një shpresë, që sjet e rrejtun
Gjithsecili dertin kjanë,

**Por si fmiija t'vetes nanë
Ja qel zemren gjith kjamet.**

**11. Aty i vorfni e derdimeni,
Vjen i verbti e vjen sakati:
E kujt n'dergj i asht kputun shtati,
Me një zë lypin t'gjithë derman,**

**12. Ulun n'gjuj pse shkrehet n'vaj
Njajo grue fytyrë për dhe?
Fryti i zemres ju ka pre,
Virgjnes Nanë i bie n'aman.**

**13. Me fmi n'prehen asht e lkur,
Fryma e jetës tuj ju kput,
Asht ardh tjetra me ju lutë,
Atij foshnje me i falë shnet.**

**14. Njajo tubë që kjanë e dnesin
Pa guxu përpjetë me kqyrë,
N'salldan t'zi, me t'mlume ftyrë
Derman lypin hallit t'vet.**

**15. M'nji fajtorët ne mni të Zotit,
N'zemër mush tallas të vshtirë
Mkatit vet me i gjet mëshirë,**

Me i gjet njesë janë ardhë n'penim.

**16. Jo: kjo Nanë s'un t'i përbuzë,
Me i pajtu dishronë me t'Birin,
Të gjithë njesës jau jep hirin
T'haznes t'Zotit pa vanim.**

**17. Derdimentit, nevojtarit
Ja sillë sytë, ja gjenë medetin,
Driten t'verbrit, t'ligut shnetin
Zemërdhimshme ja djergjon.**

**18. Te saj Emnin t'madh tuj thirrun,
Me t'sajné ujë tuj lagun ballin,
E kanë pa t'largumun hallin,
Gjith e mira s'ju vanon.**

**19. Kush me ken dishronte nanë
I kjen gjegj si i pat rigjat,
Kush perpara dneste e ngratë
Me fmi n'prehen gzueshem lot.**

**20. Me fmi kputun gjith ymytit
Pat ardh nana tuj lotue,
Tash po kthehet gazmenue
Se si shkoi rigjaja kot.**

**21. Por kush munet sallë me folun
Hiret t'ksajë t'lumneshmes Zojë?
Nuk ka njeri men as gojë
Me i permen a dile a gim.**

**22. Por sa e dashtne, e butë, e amel
Asht kjo e Lume per t'divoçem,
N'hasmit tashem, e te moçem
Ka diftumun ç'ka asht çinrimi.**

**23. Me t'zi njert me hi n'at kishë
Kush s'guxon, atij kshtenimit
Dhunë me i ba, se t'gjith renimit
T'randen barrë n'gazep e hjek.**

**24. Ispat hajnit çë me dashun
T'lumen kishë një herë guxuene,
Njeni m'tjetrin n'gjak u lshuene
E paguan me t'vështirën dekë.**

**25. Ispat cubat çë zollumin
Me i ranumun deshte venit,
T'gjithë i çbini jashta renit
E në futë të zezë i mloj.**

26. Oh gjithë lavdi, gjithë urimi,
Gjithë itati i kjoftë ksajë Nane,
Që t'Shqypnijos nerë gjithë ane
Asht sajdisë, me men, me gojë.

27. Dashtenijen t'a përtrinë
Për ket Zojë Shqypnija marë,
N'dashtë m'u rritë në kamë të parë,
Shelbim vedi n'dashtë me i gjetë.

28. Sallë i mjerë kush kësajë Nane
N'vepra t'zeza i ban qinresë,
E me mkat prep i pa besë
Zemren t'Birit ja therrë zgjet.

(transliterim i Don Nikson Shabani)

IV. 8. Atë Gjergj Fishta për Stubllën

Tek vetë Atë Gjergj Fishta, për të cilin do të lexojmë në vazhdim, bëhet fjalë për një dramë që e kishte shkruar vetë ai për Martirët e Stubllës.

Edhe sipas një dëshmie të P. Daniel Gjeçaj¹⁰, Atë Gjergj Fishta duhet ta kishte shkruar një dramë mbi „Martirët e Stubllës“, por ka mbetur në dorëshkrim në bibliotekën françeskane në Shkodër dhe në kohën e komunizmit është transferuar në Tiranë. Këto dorëshkrime duhet të jetë jenë në arkivin shtetëror të Shqipërisë. Drejtori i mëparshëm i arkivit, Shaban Sinani (që më 2004) ishte prezent në takimet e don Mikelit në Stubllë, ma konfirmoi se në arkiv ka dokumente mbi Stubllën dhe don Mikelin; a është fjala edhe për këtë dramë të Atë Fishtës apo jo, duhet të hulumtohet.

“Aso here, kur Atë Gjergj Fishta ndodhej në Manastir për Kongresin e Alfabetit (1908); kryetari i Kuvendit të Lazaristave t’atij qyteti i dëftoi dhe ia fali një dorëshkrim me të madhe ransi për historinë kishtare të Shqipnis.

Dorëshkrimi në fjalë - një kopje e të cilit gjendet sot gjithnjë në bibliotekën e Rregulltarët të lartpërmendur të Monastirit, - është shkruar në gjuhën frëngjishte nga një Misionar në Maqedoni, me mbiemrin Troveyriot¹¹ Sikur mund të vërtetohet që prej fjalëvet ma të para të dokumentit, kallximi asht shkruar në trajtën e një letre lajmimi, i asht drejtue Timz. Dario Bucciarellit, atëherë ipeshkëv i Prizrendit. I cili i ishte sjellë Zotnis Bonnieu, kryetar i kuvendit të

Lazaristavet të Sh. Benediktit në Monastir, tue e lutun t`i jipte lajme sa m te sigurta për atë çetë katolikësh nga Stublla, marrun prej turkut e dërgue në mërgim në Brus (Azi e Vogël) vjetin 1846.

Mendimi i ipeshkvit ishte, prej këso lajmesh, bashkë me shka mund të mblidhte nga vetë goja e atyne pakë dishmitarve, qi u kthyen gjallë në vend të vet, me përbledh një monografi sa m të plotsueme rreth këtyne martirve, të cilët mbaheshin me dioqez të tij.

Tash, se e ka botuem këtë kund, na nuk e dijm. Dijm vetëm, se pat gatue për me e çue në Romë; pse na kemi në dorë.

Nji dorëshkrim tjetër edhe m të gjatë mbi martirët shqiptarë të Stubllës; a m mirë të thomi, një shkurtim të historis së Timzotit Buciarelli OFM të cilën një Meshtar Françeskan i dioqezit të Shkupit, simbas urdhnit të Gjeneralit, përpiloi e i drejtoi këtij në Romë.

Nga ky dorëshkrim i dytë italisht, ne kemi për të marrë aty-këtu ndoni njohtim, qi të na duket i nevojshëm për ndritëshimin e tekstit frengjisht, të cilin po nism këtu t`a botojm të përkthym.¹²

Kurse vetë Atë Fishta shkruan për Martirët e Stubllës kështu më 1911:”

„MARTIRËT E STUBLLËS” (Kosovë), Scurtari, 20 marzo 1911.

Scutari, 20 Marzo 1911.

„...Anche io ho un manoscritto in francese sulle persecuzioni delle famiglie di Stubla in Cernagora. Veramente e assai interessante: nel leggerlo ho dovuto piangere di compassione per quei poveri niartiri, che con tanta rassegnazione cristiana hanno sopportato le

piu inaudite crudelta da parte dei loro barbari persecutori. Di quella storia si potrebbe fare un soggetto letterario di primissimo ordine; perche riuscirebbe assai caratteristico e patetico, come anche indicatissimo per la sua attualita.

Siccome il P. Antonio Markovich, francescano, e stato loro compagno dell'esilio, io ho pensato di avvisare in proposito il nostro Procuratore Generale, onde vedere se si puo iniziare la sua causa per la canonizzazione, almeno di quelli ehe sono morti durante in viaggio e sotto i colpi dei loro persecutori. Nel mio manoscritto si trovano i nomi delle singole persone e famiglie che sono state esigliate. Percio ho pensato di copiare in pulito manoscritto e spedirlo a Roina. Che ne pensi tu? Nel caso ehe anche tu fosti del mio parere, allora mi devi mandare anche il tuo manoscritto, onde completare viemeglio la storia di quei poveri marrtiri, che tanto

hanno sofferto per la Religione di Cristo. Il manoscritto mi e stato regalato dal Superiore dei Lazzaristi a Monastir ed e legalizzato col timbro della loro casa. - Anche io accarezzo l'idea di fare di quella storia un soggetto letterario: ma Dio sa quando che potro occuparmene in proposito” At Gjergj Fishta OFM. 1871-1940. Botim „DISTAPTUR“, Tirana, 1943, pp. 91-92.

S h q i p:

„MARTIRËT E STUBLLËS“ (Kosovë), Shkodër, më 20 mars 1911. „...Edhe unë e kam një dorëshkrim në gjuhën frengjishte mbi persekutimet e familjeve katolike nga Stublla në Karadak. Me të vërte të ky dorëshkrim është tejet interesant: duke e lexuar kam qarë me

lot për faqe për ata MARTIRË TË SHKRETË, të cilët me një përulje aq të madhe të krishtere dhe duke iu nënshtruar vullnësës së Zotit i kanë bartur mizoritë e padegjuara të bëra nga ana e persekutuesëve barbare. Nga kjo histori mund të shkruhet një vepër me karakter të rendit të parë letrar; sepse do të ishte tejet karakterstike dhe patetike, e po ashtu edhe indikative për aktualitetin e saj.

Duke qenë se P. Anton Markovich, françeskan, është shok i emigrimit, unë kam menduar ta njoftoj për këtë Kujdestarin e Përgjithëm tonin (Procuratore Generale) e kështu për të parë a mund a jo të fillojë PROCESI PËR KANONIOZIMIN E TYRE, së paku për ata që vdiqën gjatë udhëtimit dhe nën të ramet e persekutuesëve të tyre. Në dorëshkrimin tim gjinden veç e veç emrat familjeve që ishin të emigruar (shpërngulura) Për këtë arsye, mendoj ta përshkruaj dorëshkrimin dhe ta dërgoj në të pastër në Romë. Çka mendon ti? Nëse je i mendimit tim, atëherë duhet edhe ti patjetër të ma dërgosh dorëshkrimin tënd, kështu që sa më parë të plotësohet historia e këtyre martirëve të shkretë, që aq shumë kanë vuajtur për Fenë e Krishtit.

Dorëshkrimin ma ka dhuruar i Pari i Lazaristëve në Manastir dhe është legalizuar me vullë të Kuvendit të tyre.

Edhe unë e ushqej idenë që nga kjo histori ta bëj një vepër letrare, por Zoti e di se kur do të mund të merrem me këtë çështje.“
përfundon At Gjergji¹³

IV. 9. Die Geschichte der Krypto-katholiken (Laramanen) – Franjo Djuric¹⁴

Punimi i Franjo Djuric¹⁵ është një punim që po ashtu për publikun tonë është po thuaj se gati i panjohur. Në bibliografinë shqiptare apo të huaj nuk e hasim fare këtë punim, edhe pse ndoshta kanë të bëjnë vetëm me këtë, por nuk vërehet se u ka ra në dorë ky punim. Më 2003 ia dhashë në München Peter Bartl-it një kopje të këtij punimi dhe ai kur e pa, u befasua se nuk kishte hasur ende në këtë gjë. Punimi ka 293 faqe A4. Ky punim ka të bëjë shumë me Stubllën, pasi që autori shkruan për laramanët dhe martirët e Karatakut. Autori, shihet shumë qartë, se në disa pjesë anon kah protagonistët kroatë të ipeshkviës së Shkupit e Prizrenit. Një pjesë ia kushton edhe vetë Atë Anton Maroeviqit. Përveç asaj që deri më tani është sadopak e njohur për publikun, autori bën një gjë me interes, duke kërkuar edhe gjendjen e sotme të laramanëve në Karadak dhe jep të dhëna dhe informacione që ngjallin interesim për gjendjen e laramanëve në ditët e sotme. Dhe po ashtu kemi informacione të ndryshme për Stubllën, Letnicën, Kabashin, Binçën, Duanivin, Selishtën, Ferizajn, Lloqkobare, Slivovë, Hanroc, Sefer, Terzijaj, Karavasaria, Vrçevicë, Koreq, Zhegra, Llokme, Bresalc, Stublla e Poshtme, etj. Franjo Djuric ka edhe informacione për motrat e Shën Viçenc Paulit në Stubëll e Letnicë. Për këtë punim analizo edhe kapitullin mbi laramanët.

IV.10. Vajtmet nga Stublla

Më parë kishte publikuar Anton Çetta një këngë vajtimi (vajtim për të riun e vdekur më 1984 në klasën e 5-të të shkollës fillore Gjergj David Ramaj) dhe një përrallë nga Stublla, që për publikun tonë janë tashmë të njohura. Edhe meshtari arbëresh, Antonio Bellusci, kishte bërë më 18. 08. 1985 një gjë të ngjashme, pra ka publikuar vajtimet nga Stublla në revistën e njohur arbëreshe “Lidhja” më 1995¹⁶. Ai këto vajtime i kishte marrë dhjetë vite më parë, kur i kishte bërë një vizitë Stubllës me një grup tjetër arbëreshësh.

IV. 11. Zef del Gaudio: Martirët shqiptarë (1846-1848).¹⁷

Lidhjet arbëreshe me Stubllën ishin dhe janë të mira. Vizitat që arbëreshët bënin në Stubëll, linin përherë mbresa të mëdha në të dy anët. Autori arbëresh Zef del Gaudio (1921-2005) ka shkruar një trilogji, më sakt një dramë në tri akte, në italisht dhe në shqip mbi martirët e Stububllës, duke u bazuar në veprën e Gjergj Gj.-Gashit. Libri është botuar pas vdekjes së tij në Prishtinë.

IV. 12. Don Dedë Ramaj dhe një letër më 1966



Don Ded Ramaj u lind më 1905 në Stubëll¹⁸. Shkollimin e kreu në Shkodër dhe Sarajevë. Si meshtar ka vepruar në shumë famullina të Kosovës: në Letnicë, Stubëll, Binçë, Gjakovë, Glllogjan, e, viteve të fundit të jetës së tij, shërbeu në Novosellë. Populli ende e

kujton si predikatar të mirë. Është burgosur dhe dënuar me dymbëdhjetë vjet burg. Pas gjashtë vitesh burgimi është liruar si i pafajshëm. Shumë fëmijë të Stubllës i ka dërguar në shkollë, në mesin e tyre ka priftërinj, profesorë, doktorë shkence, shkrimtarë e poetë.¹⁹

Ka përjetuar tortura dhe mundime të shumta në burgun e Nishit. Kur doli prej burgut ishte i sëmurë rëndë dhe prej sëmundjes vdiq në banesën e famullisë së Pejës, kurse në këtë kohë ishte famullitar i famullisë së Shën Rrokut në Novosellës të Gjakovës. Varrimi është bërë në vendlindjen e vet - në Stubëll. Sipas don Robert Kolajt, Don Ded Ramaj ka lënë disa përkthime të klasikëve latin dhe që gjinden në Novosellë.

Në Vjennë shërben meshtari katolik shqiptar Don Izak Dodes (kusheri i don ded Ramaj). Letrën që po e publikojmë poshtë gjeta

tek ai, që kishte dërguar prej burgut të Nishit familjes së vet. Tek familja gjinden ende edhe letra të tjera. Poashtu edhe fotografia e don Dedës në vitet e para meshtarake. Prapa fotografisë është shënuar „Foto Zherka – Gjakovë, kruse viti nuk dihet i saktë.

Letra e don Dedë ramaj dërguar nga Burgu i Nishit:

Mat. Br. 1005/I.10

Nish, 9.VI.1966

Vllazen të dashtun,

Sot, ditën e Korpit të Krishtit po jau shkruaj ket leter.

Ju njoftoj se edhe nuk jam bënë operacion. Pres për ditë se kuer po më thrrasin. Me shndet jam mirë edhe m'u merzitë nuk jam kah merzitëna, edhe pse jam lodhë e kputë prej pleqnijet.

Kam pasë kujtue se po vini në takim për me më pë, por nuk erdht! Nji leter, si e keni pasë shkruar me 24.IV, e kam marrë me 5. V. 1966. Paketën e kam marrë, por nuk kishte pasë ardhë me postë, por e kishte pasë prue dikush me dorë! Kam shumë dishirë me më dëftue se si është kjo punë?

Shumë e shumë dishiroj me e ditë se si është puna e kishës së Shë Jozefit e pse nuk po punohet në të?

Malli më ka marrë me i pë edhe një herë ato duvare si i kam pasë lanë tek të daluna për më tokë. Malli më ka marrë me i pë famullinat e mija e shokët e më se më për rrfim, kungim e meshë mos pvetni. Për ditë, kuer të zbardhin drita, mue më bje në mend se shokët e më çohen e bahen gati për meshë; ditve fetsa më bahet se po e shof popullin ty shkue të kisha, priftin kah rrfen, kungon e thotë meshë e

predikon e tham vet me veti: „e une ku jam? Shka jam ty bâ?“ E nuk më jetë tjetër gjâ me bâ vetem se me ju shtrve vullndesës së Zotit e me bâ saber.

Shna Ndoun e kena edhë trí dit me soden. Jau fatoj Binçës ket festë të lume! Le të luten per mue se une nuk i kam harrue edhë kujtoj se jamë famullitari i tyne. Mos harrò me mâ pershndet Tadén e Andres shum. Në ardhhtë Damjani në Binçë per Shë Nda Ndue mos e le per pá e pvetë per pare a asht tuj më çue se prej Ipushkvit nuk kam marrë parë prej atëherit si mi ká çue 10.000 dinâr. Le të ma çojnë adresën e Ipushkvit se kú po rri a në Shkup a po në Ferizaj?

Paketen ne pastë mundësi me mâ çue prej me 26 (qershuer) VI e deri me 9 (ndandë) (korrik) VII. Mos më leni pa duhan. Çitne 1 kille 50 paçeta „Morava të Gillanit“.

Emanuelli si po shkon me shkollë e me shndet? Nikolla a i ká dhënë provimet per zídár? Lluka shka po ban? Marjani e Mata a po rriten? Bereqetin si e kini? A keni punue?

Në kjoftë se mundeni me ardhë e me më pá mos e leni pa ardhë, por në mos mujshi me ardhë shkrumani nji leter. Nuk e dí a âsht gjallë Mika i Munishit shndet e të fala.

Vllazen mos u merzitni. Lutni per mue.

Shndet e të fala vllaznís mar sidonos Lushit, Jakës e Sarës Zefit t'onë.

*Shndet e të fala juvet e robvet marë, kojshivet, miqvet u çoj une
Don Dedë Ramaj*

Nish, 9.VI. 1966meshtár

Mat. Br. 1005/L10 K.P.D

¹ Dieses Erzbistum zählt nach den letzten Angaben nicht 10.000 sondern 6.500 Katholiken in 6 Pfarreien, Prisrend, Jakowa, Ipek, Janjewo, Karadag und Zumai. Die Zahl sämtlicher Katholiken in Nordalabnien und Dardanien wurde im Jahre 1850 auf 96.000 angegeben. S. Alb. Studien, I, S. 19

² Krahaso: Lettere edificanti della Provincia Veneta, Serie IX, Venezia 1898, fq.. 53-81.

³ Krah: edificanti della Provincia Venta, Serie XVII, Venezia 1902, fq. 84-150.

⁴ Krah: "Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Veneta, Serie XXII, Venezia 1913, fq. 3-20

5 SLISKOVIC Jakov: ALbanija i Macedonija, Sarajevo 1904.

6 COLAK N. & Mazuran I.: Janjevo. Sedam stoljeca opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb 2000, fq. 168

⁷ GASHI.GJ Gergj: Martirët shqiptarë, fq. 268.

⁸ GJINI Gaspër, Shenjtërorja e Zonjës Cërماغore, in. Drita, 7-8, 1984, fq. 3.

⁹ BYTYQI Nue dom, Kanga e popullit. N`nderr t`Zois Zernaghores, in: Elçija e Zembrës së Krishtit, Shkodër, qershor 1894, fq. 6-9.

¹⁰ Shif Drita nr. 3-4/1983, fq 22 fusnotën 3.

¹¹ Duhet të jetë: Faveyrial. Titulli i botimit: Memoires historiques sur les familles albanaise de Tchernagora (1846), ky dokument kje botuem frengjisht në „Hylli i Dritës“, v. 1924, nn. 3-4, 5-6, 7-8, 9, 10 e 11.)

¹² kështu shkruan Atë Justin Rrota e Atë Marjan Prela te Zani i Shnanout në Shkodër më 1943.

¹³ Shif GJERGJI, Gj: Martirët shqiptarë gjatë viteve 1846-1848, in Drita, 3-4, 1983 fq, 22; poashtu Gjergj Gj.- Gashi, Martirët shqiptarë, fq. 207; Sedaj, Martirët e Karadakut sipas një kënge popullore, in: Drita, XXI, Nr. 7-10, 1990, fq, 12.

14 DJURIC Franjo: Die Geschichte der Krypto-Katholiken (Ljaramanen) in der Diözese Skopje-Prizren und die Probleme ihrer pastoraren Bedeutung, Innsbruck 1987.

15 DJURIC Franjo: është i lindur në Janjevë. Kohë të gjatë ishte famullitar në Vërnakollë e më vonë edhe në Janjevë. Shërben në Belgjikë, në misionin katolik kroat.

16 Vajtimet nga Stublla/Lamenti funebri di Stublla, Lidhja XV, 32, 30 tetor/octobre 1994, fq. 1118-1122

¹⁷ GAUDIO Zef (Giuseppe) del: Shqip “Martirët shqiptarë (1846-1848), Trilogji” - Italisht “I Martiri Albanesi (1846-1848) Trilogia”, Prishtinë 2006.

¹⁸ Don Jakë Prenku Vdiq don Dedë Rama, in Drita , viti VI, 1975. Nr. 7-8, f. 5.

¹⁹ QERKINI Agim don: Thirrjet shenjta në Stubëll fq. 58.

**V. BURGOSJA DHE LARGIMI I DOM MIKEL
TARABULLUZIT**

V. 1. Burgosja e Dom Mikel Tarabulluzit dhe Imzot Lazër Mjedës

Sipas disa dokumenteve që gjenden në arkivin ushtarak të Beograd, gjenden aktet ku Imzot Lazër Mjedës i kishte arrijtë një letër nga Don Mikel Tarabulluzi, që mban datën 15 janar 1920 në gjuhën italiane dhe dyshohet për akte që këta të dy veprojnë kundër shtetit jugosllav, sepse ata dëshirojnë që mos të mbyllen shkollat në gjuhën shqipe që gjeneshin pranë famullive nëpër Kosovë dhe Shkup. Kjo letër zihet, kurse don Tarabulluzi, edhe pse më parë (1919) burgoset për gjëra që ishin në kundërshtim me shtetin jugosllav, por prapë më 24 korrik të 1921 dënohet në gjyqin e Gjilanit me 8 muaj burg, kurse gjyqi apelativ i Shkupit ia zgjati burgun më 4 mars 1922 në 2 vite, lurse këtë dënim e vërtetoi edhe gjyqi i Beogradit. Siç duket, qeveria serbe kishte telashe më të mëdha me argjipeshkvën e Shkupit, Imzot Lazër Mjedën se sa me don Mikel Tarabulluzin, por e dinte se po të provonte këtë gjë me Lazër Mjedën, do të ketë probleme ndërkombëtare, sepse L. Mjeda ishte ipeshkëv dhe e dinte se do të ketë probleme me këtë akt. Për fat të keq, sekretari i atëhershëm i argjipeskhvisë së Shkupit, meshtari Sime Picinic, ishte ai që organizoi një komplot të madh kun dër Mjedës dhe i informonte për shumë gjëra edhe zyrtarët serbë në Prizren e Beograd për aktivitetet e L. Mjedës. Siç duket, Imzot Mjeda ishte i tradhtuar nga meshtari nga Istra, Sime Picinic dhe “jugosllavenët” kishin informacione të mjaftueshme për aktivitetin e L. Mjedës. Nga kryetari të atëhershëm i Prizrenit më 1921 (për shkak se Mjeda

bënte “atak” në popullin serb me letrat e veta që i dërgonte botës mbarë) lindi ideja për kërkesë drejtuar ministrisë së punëve të jashtme: që ai të pensionohet e kështu gradualisht krijohet mundësia për ta larguar nga ipeshkvia jo vetëm Don Mikel Tarabulluzin, por edhe argjipeshkvin Mjeda. Mirëpo, prapë se prapë, edhe për Tarabulluzin qeveria shtetërore, serbojugpsllave, mendonte se ai ishte i rrezikshëm për shtetin jugosllav. Kështu së paku paraqitej në dokumentet që atë kohë i raportonin Beogradit, por, siç duket, kjo gjë edhe po vërtetohet edhe sot. Këto gjëra i mbështesin edhe shkrimet e Nikola Zutic-it. Qeveria serbe pretendonte që selinë ipeshkvore ta shpërngulë në Shkup e të mos qëndrojë në Prizren, ku ndodhej argjipeshkvi Lazër Mjeda dhe bashkëmendimtari i tij në Stubëll, don Mikel Tarabulluzi (i cili duhet të penzionohej dhunshëm sipas Beogradit që mos të sjellë “dëme për shtet”, sepse kështu edhe mund t’u ikte kontakteve më të shpeshta me njerëz.) Ministria e dinte se Mjeda nuk është shtetas serb, por shtetas shqiptar, pasi që ai është i lindur në Shkodër. Për këtë arsye, serbët duhet t’i shmangeshin edhe probleme juridike ndërkombëtare, e jo vetëm ta gjykonin argjipeshkvin Mjeda pa ndonjë bazë juridike. Largimi nga argjipeshkvia do të ishte më i përshtatshmi për qeverinë serbe, sesa telashet tjera juridike. Ky akt nuk ishte e lehtë as për ministrin, sepse për këtë punë duhet për të vendosur Vatikani. Porse hapi i dytë që ndërmerret nga Milivoj Jovanovic, ministër për çështje fetare, ai e komandoi policinë vendore që të marrin Mjedën fshehurazi dhe pastaj të shihnin se çka do të bëjnë me të. Ishte shkak se Mjeda nuk ishte i përshtatshëm për shtetin jugosllav. Kështu, qarqet vendore, me re-

komadim të Beogradit, e detyruan Imzot Lazër Mjedën, se duhet fshehurazi ta lëshonte argjipeshkvinë dhe të ikë në Shqipëri. Së këndejmi, Mjeda duhej ta bënte këtë hap. Dhe e bëri në fillim të shkurtit të vitit 1922: shkon prej Prizrenit ku e kishte selinë ipe-shkvore të Shkupit dhe më 14 shkurt arriti në argjipeshkvinë metropolitane të Shkodrës¹. Pa dëshirën e vet e lëshon argjipeshkvinë e vet, kinse për shkak të letrës së Don Mikel Tarabulluzit të datës 15 janar 1920, ndërkohë që qarqet e sigurisë shtetërore kishin zbuluar se ai duhej të gjykohej apo ta lëshonte argjipeshkvinë.² Ishte një paragjykim i qeverisë serbe, se kleri katolik po përgatiste një lloj revolucioni kundër ushtrisë serbe në Kosovë. Kështu, në korrik të vitit 1920 policia serbe mori për t'i burgosur 3 meshtarë shqiptarë – don Shjtfën Krasniqin (Famullitarin e Gjakovës, Atë Klement Miraj (famullitar i Pejës) dhe Atë Serafin Koda-n (famullitar në Rajë-Mertur). Në vjeshtën e vitit 1921 policia e burgosi tashmë për të tretën herë don Mikel Tarabulluzin (famullitar në Letnicë), që dyshonin se do të bënin ndonjë organizim kundër ushtirës serbe në Kosovë. Këta rinin në burg pa u gjykuar fare, kurse Mjeda kërkonte që të fillonte gjykimi i tyre. Me muaj të tërë kaluan këta 4 meshtarë të pafajshëm nëpër burgje.³ Për këtë akt, propaganda e atë-hershme serbe informoi edhe opinionin publik nëpërmjet gazetës Politika të 04.06.1921. Në shkrimin me titull „Medju nama – nožem u ledja“ (ndër ne – thikën shpinës) shihet shumë qartë se kleri katolik për politikën serbe ishte ai i cili rrezikonte Serbinë dhe organizonte shqiptarët për kryengritje. Letra e 15 janarit 1920 ishte shkas për aktakuzën kundër don Mikelit; zgjon kureshtjen përmba-

jtja e kësaj letre, sipas burimeve serbe⁴: “Meqë këta fshatarë janë shumë të prapambetur, të zhveshur shpirtërisht dhe në aspektin kohor dhe meqë gjithnjë përdorin gjuhën sllave, a mos do të ishte ndoshta më mirë që pakëz t’i ngrisim dhe t’i shqiptarizojmë? Kjo mund të arrihet më së miri nëpërmes arsimimit dhe motrave të nderit. Mendoj se përmes shkollimit të fëmijëve të të dy gjinive, së shpejtë kjo trevë do ta ndërtojë pamjen dhe ne vetëm disa vite do të kemi një popullatë tjetër, që do të flasë në gjuhën tonë. Nëse kjo arrihet, unë nuk do të kurseja të flijoja për këtë vepër më tepër se gjysmën e pasurisë time”⁵. Tarabulluzi ishte burgosur deri atëherë tri herë, por kësaj radhe ishte letra shkaku kryesor i arrestimit dhe për shkak të kësaj letre u dënua me burg 2-vjeçar. Pas gjykimit, zyrtarët serbë kërkonin që Don Mekel Tarabulluzin ta largonin e ta ndërronin prej kësaj famullie (Letnicë dhe Stubëll), për shkaqe politike, sepse qeveria serbe kishte vendosur që t’i mbyllë të gjitha shkollat shqipe që gjendeshin në kuadër të famullive në argjipeshkvinë e Shkupit. Në shënjestër ishin protagonistët e këtyre shkollave, ndër ta edhe Don Mikel Tarabulluzi, i cili kishte vepruar më parë në shkollat e Shkupit, Prizrenit, Letnicës, Janjevës dhe, që prej hapjes së shkollës në Stubëll që nga viti 1905, ishte shumë aktiv. Dëshira e tij e hershme, ishte që ta hapte edhe një shkollë tjetër në Zhegër afër Gjilanit e kjo përbënte një provokim të madh për qarqet politike serbe. Imzot L. Mjeda pyetej se a do të mbes më ndonjë katolik në këto troje, po qe se vazhdon kjo politikë kundër katolikëve shqiptarë në argjipeshkvinë e tij. Qeveria serbe kërkonte armë nga popullata katolike, të cilat fare nuk i posedonin, i keqtrajtonte

banorët e pafajshëm, nëpër famullitë e Kosovës i përdorte mënyrat më ashpra kundër popullatës katolike të padëmshme e të pangatërruar. Kështu më 1921 në famulinë e Zllakuqanit u maltretuan besimtarët shqiptarë “deri sa nuk iu thyen edhe eshtrat e tyre”, në rrethin e Gjakovës janë djegur shumë fshatra dhe janë vrarë shumë besimtarë katolikë në të njëjtin vit. Kjo ishte një politikë shfarosëse që e zbatonte qeveria e atëhershme kundër popullatës katolike shqiptare për të krijuar presion në klerin katolik që të gjunjëzohej, sepse ata mbanin kontakte me tërë botën dhe i informonin vendet tjera për situatën në Kosovë e Maqedoni; por në fakt politika serbe kishte qëllimin e zhdukjes së shqiptarëve në përgjithësi. Zhvillonte edhe një lloj lufte psikike, sepse burgoseshin dhe vriteshin meshtarët (rast i katër të burgosurve më 1920/21 dhe vrasja e Atë Luigj Paliqit më 1913 apo edhe ndoshta ajo e don Zef Ramajt më 1914); kështu që me besimtarët katolikë ia dilte shumë më lehtë, po që se burgosej famullitari i tyre.

Dy pjesë nga Raportete e Lazër Mjeda mbi burgosjen e D. Mikel Tarabulluzit:

“I ndritur z. Ministër,

Në letrën time të 11 janarit informova Lart. Tuaj të Nd. se kryetari i komunës së Vitisë (krahinë e Gjilanit) në 20 dhjetor kishte zënë rob famullitarin katolik të Cëmagorës, Don Mikel Mesues Trabulluzin, sepse kishte shkuar në një vend tek një i sëmurë, pa kërkuar leje tek autoritetet lokale, por duke ditur se atij si famullitar i vjetër

i vlente çdo lloj pashaporte brenda kufijve të famullisë së tij.

Nga Vitia e kishin dërguar në Gjilan me duart prapa të lidhura, e kishin goditur me qyta pushke, e kishin lenë të ectë në këmbë për shumë orë midis baltës e shiut, megjithëse kishte me vete kalin e tij. Aty ishte futur në burg për rreth pesë orë dhe ishte denuar me njëzet ditë heqje lirie, që pastaj u kthyen në dyqind e dy dinare gjobë, që vetë ai duhet të çonte në Gjilan në 27 dhjetor. Kur kishte shkuar atje ditën e caktuar për të dorëzuar shumen e përmendur, i ishte thënë që për momentin ajo monedhë nuk pranohej, prisnin udhëzime nga Prishtina e ndërkohë i ishin bërë qortime të mëdha e kërcëmime të ashpra, sepse nxiste arbërit në revolte. Çdo shfajsim i tij nuk vlente, siç që pa vlerë ndërhyrja ime pranë Prefektit të Prishtinës, prej nga varet Gjilani. Më një janar, megjithë solemnitetin e ditës, e detyruan të nisej për Gjilan, duke mos e lejuar të celebronte meshën e shenjtë për popullin, siç e kishte për detyrë. Sapo arriti në këtë qytet, e mbyllën menjëherë në burgun e përgjithshëm në shoqërinë e keqbërësve dhe që rreptësisht e ndaluar për çdo katolik që mund të vizitonte dhe t'i jepte ndonjë ndihmë, si për të ngrënë apo për të veshur, kështu që i mjeri duket të vuante nga uria, i ftohti, shqetësimi i instikteve, veç shoqërisë së keqe me njerëz vulgarë e të pa edukuar. Pas pesëmbëdhjetë ditësh që kishte ardhur, prefekti i ri u mor me këtë çështje dhe e futën në një birucë me dy zotërinj arberorë të muhamedanë. Ditën e njezetë kur mbaronte denimi, u thirr nga prefekti e u mor në pyetje, e vënë përballë dy dëshmitarëve që thonin se e kishin dëgjuar t'u thoshte arbërorëve muhamedanë se Qeveria serbe s'e kishte të gjatë e do të vinte ajo e Arbëri-

së. Njëri nga dëshmitarët ishte një i poshtër, që në kohën e turqëve ishte bërë muahamedan, pastaj me serbët serb, me bullgarët bulgar, e tani është kthyer serb; e megjithëse njëri i shkatanrruar në çdo pikëpamje, ishte bërë xhandar në bashki dhe nga autoritet serbe mbahej si njeri i besuar. I pyetur pasi kishte dëgjuar këtë, u përgjigj para dhjetë ditësh.

Falliteti dukej qartë para të gjithëve, pastaj kishte njëzet ditë që prifti kalbej në burg.

Megjithë këtë shpifësi nuk pati asnjë qortim ndërsa Famullitari, pas disa këshillimesh iu lejua të kthehej në qelen e tij.

Kjo është e vërteta e faktit e nuk vlen të thuhet se një incident tillë ka bërë përshtypjen. më të keqe tek katoliket e mrekullinë më të madhe tek muhamedanet, të cilët nuk kanë parë kurrë prift katolik të trajtuar në këtë mënyrë të padenjë.

Unë u ankova tek z. prefekt i Prishtinës për padrejtësinë ndaj priftit të pafajshëm dhe e pyeta nëse i ka dhënë një kënaqësi të denjë, por ai nuk u dha se e kuptoi.

Prandaj jam i detruar t'i drejtohem persëri Shkllq. Suaj të Nd. e t'i lutem me këmbëngulje të denjojë ta marrë në konsideratë këtë incident të pakëndshëm e të kërkojë që të ndreqet e keqja. Pervec kësaj, po deshi Sh. J. të urdhërojë që prifti të lihet i lirë pr të ushtruar misionin e tij të shenjtë në të gjithë famullinë e tij, e cila përqafon trë komuna, sepse autoritetet nuk kanë pranuar T'ia japin këtë leje; e ky është një dhunim i hapur i lirisë së kultit. Me këtë rast, më lejoni t'i raportoj L. S. të Nd. disa

fakte, prej nga mund të nxirret mënyra e padenjë përmes të cilës komandanti i komunës së Verbovcit, Milan Diqiq, e ai i Vitisë, një Rista, i trajtojnë katolikët e këtyre krahinave.

Së pari, asnjë katoliku të këtyre vendeve nuk iu lejohet të shkoj e në Shkup, as në Kumanovë, as në Ferizaj për të shitur e blerë, kështu që të mjerët duhen të dergjen në varfëri.

Së dyti, u kanë marrë armët të gjithë rojeve e xhandarëve katolikë dhe i kanë nxjerrë jashtë çdo sherbimi.

Veç të tjerash kryetari i komunës së Verbovcit, nën pretekstin e nxjerrjes së armëve fshehurazi e zbulimit të sekreteve që nuk i duhen, i goditi e përgjaku më kryesorët e katolikeve. Pastaj për famullitarin nuk tregoi asnjë kujdes e për fjalë të kota e detyruan të bëjë disa ore udhëtim për të shkuar tek ai e për të dëgjuar atë që ai do.

Po ai nxorri me dhunë nga katolikët shumë të hollash, pa asnjë arsye të ndershme e i kercënoi me jetën cilindo që guxonte të fliste.

Nuk u sollen më mirë ato të Vitisë.

Nje fare Lenci Nout, një katolik shumë i ndershëm nga Binça, pasi e rrahën mirë, i morën djetë lira turke ari e një herë tjetër njëmijë leva bullgare.

Ndrek Gjergji po nga Binça, i morën njëzet lira turke ari e katërqind leva bullgare.

Koli Pjetrit po nga ia vend, trembëdhjetë lira turke e pesëqind leva.

Shanit të Markut, katërqind leva.

Nocit të Sebës e Tomi Zefit njëqind leva secilit.

Gruas së Gegë Zefit po nga Binça, i morën dymijë e shtatëqind leva

bullgare, sepse i shoqi me lejen e autoriteteve të Shkupit shkoi në Selanik, për te vizituar dy motrat e tij që janë Murgesha e Shen Vinkut nga Poli, në Institutin francez të atij qyteti.

Paratë u zhvatën nga një Gapi i Dodes katolik, i cili doli vullnetar për këto veprime të këtij kryetari komune. Ka edhe të tjerë, por po i kaloj për të mos të lodhur Lrt. T. Të Nd.

Megjithatë nuk mund të kaloj në hështje dëmin e konsiderueshëm që serbët e komunës së Verbovcit na kanë krijuar e vazhdojnë të na krijojnë duke prerë një numër të madh lisash të dy pyjeve që i përkasin njëri Menses Kryepeshkopale e tjetri kishës Famullitare. E megjithëse kryetari është lutur më shume se një herë nga famullitari dhe rojet e pyjeve t'i pengonin këto plaçkitje e jo vetëm s'i kanë dhenë kur kanë pasur nevojë, po i kanë shtyrë këta njerez të veprojnë keq. Lidhur me këtë problem i lutemi Shkllq. S. t Nd. të urdhërojnë që të dërgohet në vend një komision i nderuar, i cili të shqyrtojë dënimin e të përcaktojë shumën e dëmtimit.

Më vjen keq të them se autoritetet e Gjlanit dhe Prishtinës i lënë të sillen si perëndi këta prepotentë dhe nuk kujdesën për vuajtjet e popullsisë. Përkundrazi për çdo ankesë që bëhet, rëndohen mundimet. Prandaj gjendja e kësaj popullate është e mjeruar dhe padurueshme.

Raporti tjetër i Lazër Mjedës për burgosjen e D. Mikel Tarabulluzit:

Në datën 10 të këtij muaji i Nderuari Don Mikel Turabulluzi, fa-

mullitar i Letnicës, krahinë e Gjllanit, prefekturës së Prishtinës, u burgos nga autoritetet qeveritare të Gjllanit. Në datën 15 të po atij muaji zëvendësprefekti i dërgonte një telegram prefektit të Prishtinës, ku e ngarkonte t'i komunikonte Kryepeshkopit sëfamullitari i Letnicë, Don Nikel Tarabulluzi ishte dënuar për fajin kundë paragrafit të II të Kodit Penal Nr. 90, e në vend të tij të dërgonte një priift tjetër. Të nesërmen pastaj. Perfaqësuesi im më dha një letër të Ministrisë të kultit, ku më thoshte se ishte e informuar nga autoritetet e vendit, që famullitari i Letnicës, Don Mikel Tarabulluzi sillej në menyre që interesat e Qeverisë në ato krahina kërkonin heqjen e tij nga ajo famulli. Ngulmova pra ta zbatoja me shpejtësi këtë urdhër dhe ta bëja përgjegjës për vendimin e marrë!

Tani ia vlen të thuhet se Tarabulluzi do të ketë të metat e tij, por s'mund të preket në politikë, sepse nuk kujdeset, nuk ka asnjë aftësi për një shërbim të tillë.

Është për t'u ditur se kjo është e treta herë që burgoset i mjeri. Herën e parë, siç ka njoftuar në një rast tjetër Eminencës Tuaj të Nd., që në janar 1919, u mbajt për rreth 25 ditë nën praninë e keqbërësve. Faji që iu vu që se kishte shkuar për t'i shpëmdarë sakramentët një të semuri të famullisë pa lejen me shkrim nga kryetari i komunës. Famullia e tij përfshin tre komuna. Dëshën t'i vinin edhe faj politik, por dëshmitarët nuk diten ta luanin mirë pjesën e tyre dhe u duk qartë fallsifiteti prandaj nuk u denua. (Por dëshmitarët e rrëmë nuk patën denimin nga qeveria).

Të dytën herë u burgos këtë vit në të gdhirë të Shtunës së Rrëshajve. Motivi ishte se çështja e 1919 nuk kishte qenë vendosur akoma,

nga nuk e di se kush gjykatë e se duhej ta priste sentencën në burg; e pastaj sepse pa lejen e qeverisë kishte ndertuar një kishez në Binçe, për qellime politike.

(Kisha u ndertua gjatë pushtimit bullgar).

Qëndroi në burg tre ditët e Rrëshajve, pastaj u lirua për pathemelësi krimi.

Tani përsëri e kanë burgosur nën akuzën: shkatërrues të popullit dhe kundështar të Qeverisë.

Jam i Bindur, i Lartmadhërishtmi Princ, se edhe këtë herë Don Mikel Tarabulluzi i gjerë është i pafajshëm e se z. Minister i Kultit është informuar keq, pasi arsyet e pëmdjekj kundër këtij prifti janë krejt tjetër nga sa thuhet.

Një arsye, por jo kryesorja, ishte kjo se, duke qenë Tarabulluzi i nderuar famulliar i nje vendi, ku ka një Shenjëtores të Shëmtë Lumturës Virgjër Mari, Shenjtërorja e Zonjës së Madhe në Cernagore, siç duhet (që serbët e quainë manastir, e mendojnë se është si manastiri i tyre për të ardhur në qejf) është i ekspozuar ndaj vizitave të nëpunësve qeveritarë, të cilët në dukje shkojnë për gjoja shërbim, por në fakt vetëm për të ndrënë e pirë atyre që vinë. Nuk kënaq gjithnjë, sepse mbase s'arrijnë të dehen. Për këtë janë ankuar shpesh e kanë kërcënuar se do të hakmerren, aq sa e ndjeva për detyrë ta këshilloja Don M. Tarabulluzin të ishte më bujarë e t'i mirëpriste njerëzit, e t'i shmangëte mundimet e njerëzve e mos e vriste ndërgjegja!

Një arsye tjetër, e unë mendoj të jetë më e forta e që flitet nga goja e popullit edhe klerit, janë intrigat e Don Tade Ivanoviqit, të cilit e

njeh tashmë ky konregacion.

Ky, që në fillim të mosbindjes që i bëri Kryepeshkopit, ka kërkuar të shkojë në famullinë e caktuar, me kusht që ta heqë të Nderuarin Don Mikel Tarabulluzin e Letnicës; e kjo për kapriçot e tij. Natyrisht unë s`mund të t`ia jepja këtë kënaqësi, edhe pse nuk kisha person tjetër për të dërguar në atë famulli. Prandaj u dha pas manovrave të tjera dhe kështu ka marrë t`i ngrinte kundër popullit dhe qeverinë. Me popullin që më i lehtë pajtimi, po me qeverinë ja kaq me fat.

Ivanoviç është tepër në zemër të nënpunësve, e madje thuhet se paguhet nga qeveria si spiun. Është e qartë pse instituatat e tij gjëjnë terren të mirë.’⁶

V. 2. Largimi i Don Mikelit nga Stublla dhe letra e tij më 1912

Letra që është shënuar më poshtë, nuk është tërësisht sikur ajo që po sjellim në faksimil origjinalin e saj, kështu që e pamë shumë të arsyeshme që të sjellim në faksimil për shkak se letra shqip nuk është e plotë sikur ajo që ka shkruar vetë me dorë dom Mikeli. Nuk duhet ndokush që të mos publikoj të tërën, për shkaqe personale apo diçka tjetër.

Shkup, më 1 maj 1912, nr. 49

Frot i nderuar Kont,

Kam nderin t'i parashtroj krejt përunjësisht Shkelqësisë suaj bashkëngjitur një momerandum të ardhur nga famullitari e mësuiesi i deritanishëm në Stubëll Don Mikel Tarabulluzi, të cilin ia ka drejtuar konzullatës p.e mb. Me rastin e transferimit të tij në Prizren kohët e fundit.

Pranoni, shkelqësia juaj, shprehjen e tij

Haimrot

Stubëll, më 22 prill 1912

E nderuara Konzullatë PM e Austro-Hungarisë Shkup

Siç është në dijëni ajo Konzullatë e ndritur PM, sipas shkesës së Shkelqësisë së tij të Ndritur imzot argjipeshkvit të datës 3 të numrit vijues 229, unë jam transferuar nga famullia e këtushme e Stubllës në atë të Prizrenit. Kështu, përpara se të braktis përfundimisht këtë vendbanim të dashur për mua, më shkon mendja te mirëbërësit e mi më të shquar, për të kryer ndaj tyre detyrën time të mirënjohjes.

Pikërisht sot mbushen shtatë vjet e dy muaj që kur nga dita që për herë të parë shkela në këtë shtëpi, i dërguar nga eprorët e mi me pëllqim që të hapja një shkollë dhe të krijoja një kishë si degë e asaj të Malit të Zi. Ndërsa për këtë vepër kaq të madhe humanitare

dhe të krishterë, nismën dhe nxitjen e dha i Nderuari Konzul i Shkupit, i shquar zoti Para.....

Më dëshirën e Zotit, unë po largohem nga Stublla, por po lë këtu zemrën time, dashurinë time më të ngrohtë: jo, nuk mund të harroj – nëse mund të shprehem kështu – pjellën e parë të dashurisë sime. Pikërisht këtu unë kam kaluar shumë peripeci, kam derdhur djersë dhe kam harxhuar vite të shumta, vitet më të bukura të jetës sime. Pra, është më se e arsyeshme që unë ta kem kurdoherë parasysh këtë famulli timen, të cilën, që une të mendoj për të dhe që, edhe së largu, të përpiqem për të mirën e saj dhe ta ndihmoj që të përparojë. Prandaj, unë po e lë atë nën mbrojtjen e lartë të asaj qeverie PM dhe të asaj Konzullate të nderuar. Jam më se i sigurt se nën krahët mbrojtës kaq fisnikë, ajo do të pushojë e qetë, do të rritet e fuqishme dhe me lavdi do të arrijë pikësynimin e saj. Me këto shpresa dhe me këto dëshira të zjarrta, me ndjenjat e respektit më të thellë dhe të konsideratës më të shquar, kam kënaqësinë të mbetem

Shërbëtor tepër i devotshëm e i respektueshëm

Don Mikel Tarabulluzi

Famullitar i Prizrenit, 29.04.1912⁷

dell'anno imperiale, cui essi fanno eccezzione ad onore del
più grande benefattore della Polignia e della Polonia, l'Im-
peratore Francesco-Giuseppe.

Lei adunque, gloria e benedizione all'Impero Austriaco
Imperatore, gloria ed onore all'Impero Russiale di Russia per aver
essi quasi creati, ospitati, favoriti e sostenuti in tutti i
modi possibili una sì sublime opera di carità e filantropia,
di religione e patriottismo, quale è questa della fondazione
della scuola e parrocchia a Stulba. Ed io da parte mia non
ho che unire i più alti ringraziamenti all'Imperatore, ed a
costo Impero Russiale per tanti e sì segnalati benefici resi a que-
sta parrocchia durante tutto il tempo della mia amministrazione.
Vede, come sono per quei molti accolto all'ombra mia
persona. Nella mia incapacità non prendo in altro modo ed
a mostrare la mia gratitudine, se non col rinnovare la pre-
te di una più ancora e leali fedeltà, e ardenti attaccamenti,
ecco che oggi lasciando Stulba per andare a Graz con scopo di
veder sempre essere e ampararmi dai devoti protetti e leali
al Imperatore Polacco ed al Russiale che li rappresentano.

Ma se mi è lecito di avanzare un'umile preghiera,
la prego di dire: quella opera benemerita che mi si addimanda
qui a Stulba, e quella fiducia che in me ebbe costo Impero
Russiale, me li si voglia continuare anche la a Graz
nella mia nuova posizione. Ed io, quanto è da me,

farò il possibile per sempre corrispondere degnamente.

A Dio piacendo, io sarò da Stulba, ma si levi il
mio cuore, il mio più tenero affetto per essa: non posso, non
dimenticarmi, se così posso esprimermi - la prima figliuola
del mio amore. E qui dove io ho sostenuto tanti benefici
opere tanti sudori, e spesi tanti oneri e più tutti della
mia vita. E dunque più che ingratulo che io l'abbia
opere presso questa mia cara parrocchia, che ed essa, e
che anche di lontano me procuri il bene, me favorisca
il progresso. La adunque la prego sotto il nome dell'alta
protezione dell'Imperatore e di costo Impero Russiale.
Tanto più che siccome che sotto le ali di sì nobile patriottismo
essa riposa tranquilla, creca vigore, e fiorisce quan-
to al più alle destina.

Con lei buona e leali speranze, e con tutta
mia più proferta stima e più considerazione mi
prego rispettuosamente

K. K. Meterr.-ungar. Consulat Desk

Eingelangt am 29/10 1911.

L. f. ach, mit 340 realen, Beilagen,

Bezugs No. 11

Carl Reichert Off.

demselben, obenerwähntem
Michael H. Reichert
Baron de Parys

1 Krah. FISHTA Filip: Njoftime historike mbi argjipeshkvijt e Shkupit , Hylli i dritës, vj. X. nr. 11, 1934, fq. 552.

2 Për këtë ka akte të mjaftueshme në arkivin jugosllav në Beograd, në dosjen „Ministarstvo inostranih poslova – politicki arhiv (1922-1923) dhe Ministarstvo pravde – versko odeljenje sidomos 26-28 po ashtu e konfirmon edhe Nikola Zutic, sidomos në: Rimokatolicka misija i klerikalizam na Kosovu i Metohiji u kraljevini Jugoslaviji, fq. 105-113; Vatikan i Albanici. U prvoj polovini XX veka do 1941 krahaso faqet 102-107; Kraljevina Jugoslavija i Vatikan. Odnos jugoslavske drzave i rimske crkve 1918-1935, Beograd 1994; (së bashku me Ljubodrag Dimic) Rimokatolicki klerikalizam u Kraljevini Jugoslaviji, Beograd 1992; Srbija, Vatikan i Albanci u XX veku, fejton në gazetën beogradase Glas javnosti 16-26 shkurt 2003.

3 COLAK N.- MAZURAN I.: Janjevo, fq. 189, që shenohen dokumente arkivore të Vatikanit - Arhivin e Propagande Fide, Affari ecclesiastici straordinarii, Austria-Ungheria, fasc. 448, post. 1052-1056, nr. 628, fol 56-59, dhe poashtu fasc. 600. Fol. Pos. 1475-1476, fol. 28.

4 ZUTIC Nikola: Vatikan i Albanici. U prvoj polovini XX veka do 1941, fq. 104-105.

5 Shqip nga: DRANÇOLLI J.: Tarabulluzi dënohet me akuzën se donte t'i bashkojë shqiptarët, fq. 11.

⁶ Botuar nga GASHI Gjergj: Kosova. Altari i Arbërisë 1910-1941, Imzot Lazer Mjeda, Tiranë fq. 131-134 dhe 161-163.

7 Arkivi i Institutit të, Tiranë, Fondi i Arkivit të Vjenës, D.: 22-13- 1357 shënuar sipas Hysen Terziu, Ramë Abdylit dhe bashkluftëtarët e tij, Prishtinë 1997, fq. 198.

VI. URANIUMI I TEPËRT NË STUBËLL?

VI. Uraniumi i tepërt në Stubëll?

Është përfolur shpesh se në kodrën rrëzë Stubllës që quhet Stubllavaçë duhet t'ëketë uran. Hulumtimet janë bërë nga disa institucione të ndryshme qysh para 1999 në Stubëll. Kështu që edhe ka disa publikime për këtë punë. Një dër to është edhe ky që po e sjellim në gjuhën angleze ashtu si është publikuar, pa bërë ndonjë ndryshim në tekst apo në emra, pra ashtu siç janë shënuar në këtë publikim janë edhe këtu, sikur forma Gronja Stubla apo edhe gjëra të ngjashme.

VI. 1. Field experience of indoor thoron gas measurements in a stable rural community in Yugoslavia

Z.S.Zunic 1, K.Fujimoto 2, J.P.McLaughlin 3, A.Birovljev 4

1 Institute of Nuclear Sciences "Vinca", Belgrade, Yugoslavia.

2 National Institute of Radiological Sciences, Chiba, Japan.

3 University College Dublin, Dublin, Ireland.

4 Norwegian Radiation Protection Authority, Osteras, Norway

ABSTRACT

Attempts were made in Yugoslavia to identify rural populations receiving an elevated natural radiation exposure that might be a potential cohort for a planned future health study. In Gornja Stubla at Kosovo in southern Yugoslavia many houses are built mainly from local rock of trachyte which has a uranium content of the order of 25g/t, Th of 61 g/t and K-40 of 5.4%. Thoron and radon gas measurements were carried out in 49 locations in 23 houses in this rural community. Taking into account the short half-life of thoron passive alpha track dual radon-thoron detectors were placed within 10-20 cm from the walls, which were considered the potential source of thoron. Thoron concentrations were found to be ex-

tremely high in Gornja Stubla with a maximum measured value of 1,156 Bq m⁻³. Using another type of passive radon detector ,designed by SSI/NRPB, annual indoor radon concentrations were measured. The highest indoor radon concentration of 9,591 Bq m⁻³ was found in the same house, which had the highest thoron concentration. The absorbed dose rate in air,due to external penetrating radiation was also measured and the highest value found in Gornja Stubla was 430 nGy h⁻¹. Although high thoron concentrations were recorded it should be pointed out that due to its short half life large differences in thoron concentrations are to be expected as a function of the distance of the measuring point to the source. In addition, with the absence of information on thoron progeny concentration it is impossible to make any estimate of doses from the thoron series since the equilibrium factor between thoron and its progeny can vary greatly with time as well as location. However, the thoron measurements that have been performed in Gornja Stubla clearly indicate that the inhabitants there receive an elevated exposure not only from indoor radon and penetrating radiation but also from thoron.

INTRODUCTION

In recent years there has been a growing interest in the exposure of the general population to elevated levels of natural radiation (1). Attention has focussed ,in particular , on exposures due to radon gas (222Rn, T1/2 = 3.83 days) and its short-lived progeny. A number of large case-control epidemiological studies on exposure of the general population to radon in the indoor residential environment have been completed in recent years. Meta analyses of these studies indicate that the estimated risk from indoor residential radon exposure is similar to that expected on the basis of the miner radon epidemiological studies (2) While these radon studies are helping to increase our knowledge on the health effects of natural radiation exposure there has been almost no attempts to assess the health implications of exposure of the general population to indoor thoron (220Rn, T1/2= 55 s) and its progeny. Part of the reason is probably

because due its short half-life the dynamics of thoron and its progeny in the indoor air environment is not well quantified or understood and also because measurement of thoron and to a lesser extent its progeny is more technically difficult than that for radon and its progeny. Even if good thoron progeny data is available difficulties exist in making meaningful dose estimates as lung dosimetry modelling for thoron progeny is presently in a less developed state than that for radon progeny. (3).

It has been long known that thoron can be a problem in the working environment in mines and in premises where Th-232 rich minerals, sands or products are handled in large quantities. In the past decade it was pointed out that under certain circumstances thoron may cause relatively high exposures in dwellings particularly in well insulated homes overlying geological formations with an elevated thorium content. Results of thoron concentration measurements in indoor environment show that only in a small number of countries have indoor thoron monitoring activities been conducted (1). This paper deals with the results of an initial survey of indoor thoron concentrations made in a community in the south of Yugoslavia already known to have elevated levels of indoor radon and penetrating radiation doses.

SELECTION OF FIELD AREA

In Yugoslavia there exists uranium and thorium anomalies as well as former uranium mining districts and uranium ore deposits. The rural community of Gornja Stubla in the south east of the southern Yugoslav province of Kosovo was first identified as a potentially suitable field study area as a result of radiometric data acquired some years ago during a uranium prospecting campaign being then carried out in the area.

It has since has been found to be an area of high natural radiation exposure in the indoor environment with an estimated annual effective doses of 16.2 mSv /y due to the combined effect of indoor radon and external natural radiation exposures (4,5). It is located on the margin of the large Vardar Zone geotectonic unit. The commu-

nity is built on a contact area of lower Cretaceous flysch and granite, Paleogene sedimentary rocks, trachyte and trachyte tuff. The underlying geology is a mixed uranium-thorium anomaly with a uranium content of the order of 392 Bq/kg, Ra-226 of 249 Bq/kg, Th-232 of 181 Bq/kg and K-40 of 1751 Bq/kg. In this community many houses are built mainly from local trachyte rock. The identification of high radon level houses and the presence of elevated Th-232 in the local geology and building materials gave a stimulus to initiate indoor thoron measurements.

Including its immediate surroundings it has a population of approximately 3000 people. A particularly interesting feature of the area from a radiological health study perspective is that it is very unpolluted environment with no industrialisation . The population is also quite homogeneous and stable having living for many generations there with very little outside influence on its genetic pool. Having fortunately largely escaped the effects of the recent conflict it is gratifying to note that this situation has not significantly changed.

ANNUALISED INDOOR RADON MEASUREMENTS

Indoor radon gas concentrations were measured using closed passive diffusion alpha track type radon detectors. The alpha track registration medium is CR-39 mounted inside a black conducting plastic shell of NRPB/SSI design. For the etching and optical microscopy procedures used the detector sensitivity to radon exposure was determined to be 2.7 tracks cm⁻² /kBq m⁻³ hour.

The mean annual indoor radon concentrations in a total of 65 dwellings in Gornja Stubla were obtained by placing a detector in a living area in each dwelling every three months to form a sequence of four such measurements over a twelve month period. The results obtained are summarised as follows both in terms of annual mean radon gas concentrations and estimated annual effective doses.

The arithmetic mean annual radon concentration was found to be 447 Bq/m³ while the geometric mean was 336 Bq/m³ . On an individual dwelling basis the highest annual radon concentration

measured was 6010 Bq/m³. The annual effective doses were estimated using the recently suggested dose conversion factor (DCF) of 7.3 mSv WLM-1 as this value is probably more applicable to the aerosol conditions found in dwellings than the DCF of approx 4.2 mSv WLM -1 as suggested by the ICRP for high aerosol conditions (6). When the radon levels and estimated annual effective doses in Gornja Stubla are compared to world and European average values it is clear that this may be considered as a high radon exposure community (7).

COMBINED RADON AND THORON INDOOR MEASUREMENTS

Thoron (²²⁰Rn) gas measurements were made using a special passive alpha track dual thoron/radon gas detector type which consists essentially of two interconnected plastic hemispheres (8). As the air diffusion exchange time rate from the first hemisphere into the second is much greater than the radioactive decay constant of thoron ($T_{1/2} = 55s$) the alpha track signal recorded by an alpha track detector within the second hemisphere is essentially due only to the radon series while that in the first hemisphere is due to both the radon and the thoron series. Analysis of the track densities allows separate determinations of the radon and thoron concentrations to be made.

Using these detectors measurements of thoron and radon were made in a total of 22 dwellings in Gornja Stubla. The majority of these measurements were of a duration between 1 and 6 weeks. Due to seasonal variations the values obtained cannot be considered as being representative of long term or annual values. The measurements took place in two phases. Phase 1 measurements were carried out in 14 dwellings during the period September/October 1998 and Phase 2, involving 8 dwellings was carried out during the period December 1998/January 1999. Because of its short half life the indoor air thoron levels can be reasonably expected in most normal dwellings to mainly originate in the wall or floor materials. In Gornja Stubla these are largely com-

posed of the local stone with high Thorium content. Again due to its short half life thoron air concentrations will be greatest closest to its source and in this work the detectors were all placed between 10-20 cm of the walls. The results of these combined thoron/radon measurement in the rooms of the 22 dwellings are shown in Table 1a (Phase 1) and Table 1b (Phase 2). . In the last column of Tables 1a and 1b, for comparison purposes,are shown the annual radon concentration previously obtained in the same dwellings using NRPB/SSI radon detectors. Notwithstanding the large uncertainties in individual thoron determinations the short-term thoron concentrations as a group are unusually high with the majority of them being some hundreds of Bq/m³ and with an individual thoron concentration as high as 1,156 Bq m³ Bq/m³ being recorded. The short-term radon concentrations also obtained by the combined thoron/radon detectors are also unusually high with a maximum value of 2053 Bq/m³ being recorded. This latter value was found in the same dwelling which also had ,within this group of 22 dwellings, the maximum determined annual radon concentration of 6010 Bq/m³. Due to a number of factors such as seasonal and other short term variations as well as aspects of the responses,calibrations and sensitivities of the different detector types used it cannot reasonably be expected that the short term and annualised radon concentrations will be in agreement. Nevertheless it is clear that the exposures to occupants of these dwellings from indoor thoron/radon and their progeny are high and warrant further and more detailed investigations.

During these short-term measurements NRBB/SSI radon detectors were also exposed together with the dual thoron/radon detectors. The results obtained from these are shown in the second last column of Tables 1a,1b . While these detectors also recorded high radon values there is not good agreement in absolute concentration terms with the radon values determined during the same time period using the combined thoron/radon detectors. This aspect of the results is being currently examined at present and when resolved will be reported elsewhere.

CONCLUSION

While in some cases very large uncertainties are associated with the thoron values nevertheless these thoron measurements indicate that elevated exposures to thoron progeny are likely in Gornja Stubla dwellings. While no measurements of thoron progeny were made it is planned to do so in the future.

In the present absence of information on thoron progeny levels in the dwellings it is impossible to make any estimate of doses from the thoron series. Even if thoron progeny data were available it is clear that it will be very difficult to make meaningful dose estimates (3). These and other similar surveys showing the presence of high thoron levels in normal dwellings should help to provide a stimulus to improve our understanding of thoron lung dosimetry.

ACKNOWLEDGEMENTS

The authors wish to acknowledge the generous cooperation of the people of Gornja Stubla (Kosovo) in the field work described. The assistance given by Dr Rolf Falk (SSI Stockholm) in helping to facilitate the commencement of this work is greatly appreciated.

REFERENCES

1. UNSCEAR. Sources and Effects of Ionizing Radiation, United Nations Scientific Committee on the Effects of Atomic Radiation. Report to the General Assembly, E.94.IX.2, United Nations, New York (1993).
2. BEIR VI Report, Health Effects of Exposure to Radon, National Research Council, ISBN 0-309-056454, National Academy Press, Washington D.C. (1999).
3. C.Nuccetelli and F.Bochicchio. The Thoron Issue: Monitoring Activities, Measuring Techniques and Dose Conversion Factors. *Radiat.Prot.Dosim.* 78, 59-64 (1998).
4. B. Jakupi, Kristic.G, M. Tonic and R.Ilic, Radon in Mines and Dwellings in Kosovo and Metohia. *Radiat.Meas.*28, (No 1-6), 691-694 (1997).
5. Z.S. Zunic, J.P,Mc Laughlin, C.Walsh and R.Benderac, The use of SSNTDs in the Retrospective Assessment of Radon Exposure in High

Radon Rural Communities in Yugoslavia , Radiat.Meas.31, (No 1-6), 343-346 (1999).

6. J.Porstendorfer and A. Reineking, Radon: Characteristics in Air and Dose Conversion Factors. Health Physics , 76(3), 300-305 (1999).

7. B.M.R. Green, J.S. Hughes and P.R. Lomas, Radiation Atlas, Natural Sources of Ionizing Radiation in Europe, EUR 14470, Commission of the European Communities (1993).

8. M.Doi, S.Kobayashi and K.Fujimoto, *A Passive Measurement Technique for Characterization of High-risk Homes in Japan due to enhanced levels of Indoor Radon and Thoron Concentrations.* Radiat.Prot.Dosim.45, 425-430 (1992).

Table 1a : Indoor Thoron (Tn) and Radon Measurements in Gornja Stubla . Phase 1.

DETECTOR AND HOUSE CODES	DUAL DETECTOR (Short-term) Tn (Bq/m ³) ±s.d.	DUAL DETECTOR (Short-term) Rn(Bq/m ³) ±s.d.	NRPB/SSI Detector Short-term Rn (Bq/m ³)	NRPB/SSI Detector Annual Average Rn (Bq/m ³)
Y1(1)	1156±573	2053±149	3947	6010
Y2(1)	603±248	818±66	1119	1534
Y3(1)	364±109	291±29	411	718
Y4(1)	331±96	296±25	312	409
Y5(1)	422±85	243±22	296	438
Y6(1)	358±57	258±23	361	282
Y7(1)	357±91	220±24	389	943
Y8(1a)	144±36	137±10	690	186
Y9(2)	708±217	689±57	1082	1223
Y10(2)	527±223	725±59	339	1795
Y11(3)	635±109	592±44	727	796
Y12(4)	113±48	125±13	29	297
Y13(4)	103±43	107±12	14	300
Y14(5)	467±113	294±29	485	781
Y15(5)	122±29	52±7	83	138
Y16(6)	544±127	339±33	433	718
Y17(7)	172±57	154±15	109	207
Y18(8)	1116±173	467±42	809	844
Y19(8)	1034±167	451±41	1880	621
Y20(8)	752±184	614±47	1272	594
Y21(9)	945±127	300±30	456	973
Y22(10)	87±	82±66	1287	1031
Y23(10)	786±243	846±63	1761	1245
Y24(11)	416±102	256±27	468	671
Y25(11)	383±50	174±15	172	58
Y26(12)	386±79	223±20	268	424
Y27(12)	97±44	108±12	69	456
Y28(13)	934±409	1428±107	2594	2719
Y29(13)	96±48	164±13	223	162
Y30(13)	118±44	146±12	320	214

Table 1b : Indoor Thoron (Tn) and Radon Measurements in Gornja Stubla . Phase 2.

DETECTOR AND HOUSE CODES	DUAL DETECTOR (Short-term) Tn (Bq/m ³) ±s.d.	DUAL DETECTOR (Short-term) Rn(Bq/m ³) ±s.d.	NRPB/SSI Detector Short-term Rn (Bq/m ³)	NRPB/SSI Detector Annual Average Rn (Bq/m ³)
Y2-1(32)	461±252	903±66	1680	1096
Y2-2(32)	162±130	44±35	690	351
Y2-3(50)	747±125	385±31	766	940
Y2-4(50)	279±70	203±18	373	706
Y2-5(6)	231±63	177±16	259	152
Y2-6(6)	523±77	206±19	248	164
Y2-7(8)	230±50	128±13	179	164
Y2-8(19)	558±286	1029±74	2192	978
Y2-9(19)	482±336	1227±88	2594	1571
Y2-10(33)	359±154	526±40	765	646
Y2-11(33)	146±136	470±37	706	365
Y2-12(53)	195±60	171±16	258	182
Y2-13(53)	65±74	236±21	1161	513
Y2-14(23)	-300±128	462±36	712	523
Y2-15(10)	698±288	1031±75	2274	1711
Y2-16(16)	759±89	260±21	405	345
Y2-17(16)	351±79	253±20	504	1337
Y2-18(15)	213±111	385±29	548	540
Y2-19(15)	163±141	504±37	780	785

**VII. LOJTARËT E KOMBËTARËS ITALIANE
DI FRANCESCO DHE TOMMASI VIZITONË
STUBLLËN**

VII. Lojtarët e nacionales itailane vizitojnë Stubllën – Eusebio di Francesco & Damiano Tommasi

Ndoshja për dikë duke si ëndër kur i sheh këta dy emra, por kjo është e vërtetë, pepse më 13.11. 2000 dy futbollistët e njohur në tërë botën të ekipit AS ROMA Francesco dhe Tommasi bënë një vizitë Stubllës, ku edhe luajtën në fushën polivalente (për futboll të vogël, basketboll, volejball etj.) posainaugurar një ndeshje, që gjindet në oborrin e shkollës fillore dhe të mesme në qendër të fshatit. Këtë fushë e kishte financuar organizzata italiane IPSIA dhe me këtë rast



kishte ftuar dy futbollistët e Italisë që jo vetëm shikuan, por edhe kohë të shkurtër luajtën në këtë fushë me stubllasit, konkretisht me KF Stublla, që është themeluar ëysh në vitet e 70. Në këtë ndeshje muarrën pjesë edhe KF Vitia dhe KF Binça. Atmosferën edhe më madhështore e bëri akti i prerjes së shiritit nga

futbollistët e FC.Roma, shkembimi i dresave të ekipit FC Roma dhe KF Stublla, flamujt dhe emblemat e tyre e ku ishin nenshkrimet e të gjithë futbollistëve, ndërkaq në një nga dresët e ekipit AS Roma ishte shënuar "STUBLLA 2000" (shif edhe foton) dhe iu kishte dhuruar ekipit futbollistik Stublla. Kurse KF Stublla, ia dhuroi poashtu amblenen e vet lojtarëve romakë. Pas ndeshjeve miqësore që u zhvilluan në këtë fushë sportive, u zhvillua enkas për këta dy futbollistë-mysafirë një program kulturoro-artistik, që kishin përgatitur të rejat dhe të rinjët e Stubllës. Dhe pas përfundimit të programit ishte darka solemne për mysafirët nga Italia që kishte përgatitur Famullitari i Stubllës Don Rrok Gjonlleshaj në bashkpunim me stubllasit me që rast këtyre dy futbollistëve italian KF Stublla ua dhurroi mirënjohjet e veta si shenjë falenderimi dhe rrespekti që kishin vizituar Stubllën.

Duhet cekur edhe këtë se FC Roma, kishte vendosur që shumën vjetore të kampionatit të kaluar të dënimeve të brëndshme të lojtarëve (për vonesa në ushtrime, për ndoj sjellje të pahijshme etj.), që kish mbërritur në 31 milionë lira (rreth 16.000 euro) ta investojnë në Kosovën e sapodalur nga lufta. Për këtë hap humanitar dhe solidar me rininë e Stubllës e kishin ndërmarrur këta dy futollistë nga AS Roma që vizituan Stubllën, të cilët edhe e kishin udhëhequr procedurën e dënimeve të brëndshme - Tommasi e Di Francesco. Për ndërmjetësimin e ardhjes së tyre më së shumtu bëri Pashk Balabani, Stubllas që jeton në Lecco të Italisë.

Në këtë çdo verë në fund të korrikut apo fillim të gushtit, pra sipas marrëveshjeve që bëhen dhe kur arrinjë stubllasit nga vendet pë-



rëndimore, luhet turniri tradicional “Engjëll Zefi”. Për këtë përgatitën shumë ekipe futbollistike, jo vetëm të rriturit, pro edhe turniri për fëmijë të vogël dhe krijohet 2-3 ditë një atmosferë familiare mes të

rinjëve stubllas dhe bëhet një lloj cerimonie me shpërndarjen e medaljeve dhe kupave për vendet e caktara dhe në fund të kësaj organizohet një mbrëmje muzikore dhe festive. Mediat jo vetëm shqiptare, por edhe ato italiane i kishin dhënë jehonë kësaj vizite, ndër të tjera edhe këtë:

VII. 1 Damiano ed Eusebio a Stublla

Abbiamo identificato un modello di finanziamento e di progetto nell'esperienza compiuta a Stublla, in Kosovo, dall'Unione Sporti-

va Acli e dai giocatori della Roma. Nella prima fase, la sottoscrizione, si sono raccolti i 31 milioni delle "multe interne" della squadra; nella seconda l'Ipsia, l'organizzazione di cooperazione internazionale delle Acli, si è occupato di attrezzare il campo di un complesso scolastico di questa località del Kosovo al confine con la Macedonia, dove oggi i ragazzi possono giocare in un impianto polivalente con canestri per il basket, porte per il calcetto e la pallamano, rete per la pallavolo e reti protettive. Il campo è stato inaugurato il 13 novembre 2000 da Damiano Tommasi ed Eusebio Di Francesco, in una giornata che ha visto i due atleti, insieme ai giornalisti Valerio Piccioni (Gazzetta dello Sport) e Giovambattista Notarianni (Corriere dello Sport), immersi all'improvviso nei problemi difficili del dopo conflitto.

VIII. BIBLIOGRAFI MBI STUBLLËN

VIII. Bibliografi mbi Stubllën

Bibliografia nuk është shtrruese dhe është vetëm deri në vitin 2006 kur është shkruar ky libër. Të gjitha këto libra, artikuj apo edhe shkrime të shkurta kanë të bëjnë direkt apo indirekt me Stubllën apo edhe rrethinën e Karadakut. Disa libra në shuhë të huaja që janë të shënuar në këtë bibliografi por në fakt janë nganjëherë disa faqe, rreshta apo vetëm shënime të shkurta kur përmendet Stublla.

[Marino BIZZI]. Franjo RACKI Izvjestaj barskoka nadbiskupa Marina Bizzia o svojem putovanju god. 1610 po Arbanaskoj i Staroj Srbiji. Ne: Starine. Na Sviet izdaje Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti 20(1888) fq. 50-156.

AHMETI Isak: Don Mikeli, pishtar i arsimit në Kosovë, in: Shkëndija, shtator 1990.

AHMETI Isak: Kosova, Prishtinë 1996.

AHMETI Isak: Në Stubllëll ishte shkolla e parë shqipe në Kosovë, in: Shkëndija, tetor 1990.

AHMETI Isak: Shkolla e parë shqipe në Karadak, in: Rilindja Prishtinë 15. V. 1970.

AHMETI Isak: Shkolla e Parë Shqipe në Kosovë, in: Shkëndija nr. 1-2, Prishtinë, 15.01.1976.

AHMETI Isak: Stublla me shkollën e parë legale shqipe në Kosovë, in Stublla. Monografi. 2005.

AHMETI Isak: Stublla me shkollën e parë shqipe në Kosovë, in: Bota e re, 1.10.1983.

AHMETI Zef (bashk me RAMAJ Alber): Stubllasit në mërgim, in: Stublla. Monografi. 2005 fq. 138-146.

AHMETI Zef: Nga martirizimi në emigrim, ese (manuskript) St. Gallen 2006

Albanian Catholic Bulletin 1-15 (1981-94), Albanian Catholic Institut, San Francisco.

ASLLANI Uran: Studentët shqiptarë në Austri. Roli i tyre në pavarësinë, konsolidimin e zhvillimin e shtetit shqiptar, Tiranë 1992-1998.

- BARTL Peter:** Kryptochristentum und Formen des religiösen Synkretismus in Albanien. In: Grazer und Münchener Balkanologische Studien. München 1967. S. 117-127 (= Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahen Orients 2). Përktimi shqip: Kriptokrishtenizmi dhe format e religjionit sinkretik të shqiptarëve, in: Urtia, X, 1 (15) 2002, S. 107-119.
- BARTL Peter:** Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung (1878-1912). Wiesbaden 1968.
- BARTL Peter:** Kosova and Macedonia as Reflected in Ecclesiastical Reports. In: Arshi Pipa and Sami Repishti (Hrsg), Studies on Kosova. New York 1984. S.23-39 (shqip versioni më i zgjëruar: Relacionet e priftërinjëve vizitatorë si burim për historinë e popullit dhe kishës shqiptare, in: Urita, VIII, 1, 2000, fq. 37-76.
- BASHA Tefik:** Vështrim mbi popullsinë e Anamoravës, Takimet e don Mikelit II (1993-1994), fq. 79-88.
- BELLUSCI Antoni:** vajtimet nga Stublla/Lamenti funebri di Stublla (18/08/1985), Lidhja XV, 32, 30 tetor/octobre 1994, fq. 1118-1122
- BERISHA Mujë S.:** Zeqë Vërbani dhe koha e tij, Prishtinë, 1997, fq. 137-169
- BEXHETI Nuri:** Die Teilnahme der Albaner am "Großen Türkenkrieg" 1683-99, (disertacion), Vjenë 2005.
- Blagoves:** Kosovski ljaramani-mucenici, nr. 5-6, fq. 5-12 Beograd 1969
- Blagovest:** O. Antun Maroevic, kosovski mucenik, nr. 3, 48-49 dhe nr. 7-8, 134 Beograd 1973.
- BRESTOVCI Sadulla:** Lëvizja kombëtare shqiptare në kazanë e Gjilanit, Rilindja Nr. 4394, 24. VI. 1971.
- BRESTOVCI Sadulla:** Marrëdhënjet shqiptare - serbo-malazeze (1830-1878) Prishtinë 1983
- BYTYQI Nue don:** Kanga e popullit. N`nderr t`Zois Zernaghores, in: Elçija e Zemrës së Krishtit, Shkodër, qershor 1894.
- Catalogus defunctorum S.I.(1814-1970) br. 20197.**
